



Dëlirja e zemrës



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 07 (482)
Korrik, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Dëlirja e zemrës / Mehmet Disha

8 Hixhreti profetik, fitore e dritës mbi errësirën / Dorian Demetja

10 Lajme / Aktivitete



14 Ihlesi është thelbi dhe shpirti i veprave tuaja / Fatih Degjimenli

18 Qëndrueshmëria në Islam / Naim Drijaj

22 Profeti ynë fton njerëzit në islam duke shëtitur
rugë më rugë e pazar më pazar / M. Jusuf Kandeheleu

24 Detyrat e zemrës / Dr. Bekir Topaloglu

26 Dita e Ashuras, vlera dhe mirësia / Islam Agoli

28 Respekti ndaj emrit të Muhamedit a.s. / Redaksia



30 Sinqeriteti e frytet e tij / Hasan Tahsini

32 Hafiz Ibrahim Repishti (1882-1943) / Personalitet

34 Edukimi fetar merret që në barkun e nënës! / Ana Haxhiu

36 Përkujdesja dentare dhe higjiena orale / Sherife Kalaja

38 Kujdesi për jetimin / Redaksia



Dëlirja e **zemrës**



Besimtarët janë të bindur se punët dhe veprat e tyre shënohen nga Melaiket shënues, Kïramen Katibinët.

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik thotë kështu: "ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.(Infitar 10-12).

Çdo punë që bën njeriu, qoftë edhe e vogël sa atomi, këta melaike e shënojnë në fletorën e veprave, e cila do të paraqitet përpara nesh ditën e gjykimit si argument pro apo kundër.

Allahi i Lartësuar thotë: "kKush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë. (Zelzele 7-8)

Këto melaike shënojnë atë çfarë njeriu vepron në të jashtmen e tij, mirëpo ata kurrsesi nuk e dinë atë çfarë njeriu ka në zemrën e tij. Prandaj gjykimin përfundimtar të veprës tonë e jep vetëm Allahu i Lartësuar, Ai i cili di qëllimet dhe njeh sekretet e zemrave tona. Njeriu është gabimtarë dhe kjo është botërisht e ditur. Nuk ka asnjë njeri pa gabime dhe gjynahe, perfeksioni është cilësi e Allahut të Lartësuar.

Në lidhje me këtë i dërguari I Allahut (a.s) thotë: "Ademi (a.s) gaboi, po ashtu gabuan dhe bijtë e tij, Ademi (a.s) harroi, po ashtu harruan fëmijet e tij (Tirmidhiu). Gjëja më e rëndësishme mbas gabimit me dashje apo harresë, është pendimi me sinqeritet kundrejt Allahut të Lartësuar, sepse në këtë formë njeriu fiton një cilësi të mirë dhe bëhet prej njerëzve të cilët zotërojnë cilësi dhe virtyte të mira, siç është cilësia e kërkimit të faljes. Thotë i dërguari I Allahut (a.s): "Çdo bir i Ademit është gabimtarë, por më i mirë i gabimtarëve është ai i cili pendohet." (Tirmidhiu, Ibn Maxhe)

Njeriu çdo gabim që bën duhet ta pasoj me pendim dhe kërkim falje (teube, istigfar), për vetë faktin sepse është një prej cilësive më të dashura të Zotit.

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik na mëson që njeriu duhet ti kërkoj falje Zotit për gjynahet dhe gabimet e tij, qofshin këto me dashje apo jo, me vetëdije apo në harresë.

Allahu thotë kështu në Kuran: "Zoti ynë mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim". (Bakare,286).

Kur njeriu këshillohet që të kërkojë falje për gjërat të cilat ai ka vepruar pa dashje ose në harresë, atëherë nga kjo kuptohet se sa e rëndësishme është dhe sa shumë duhet që njeriu të kërkoj falje dhe të pendohet për gjërat të cilat i vepron me vetëdije.

Prandaj ruajtja nga gjynahet duhet të jetë qëllimi dhe preokupimi më i rëndësishëm në jetën e besimtarit.

Duhet që besimtari të mbrojë zemrën e tij nga gjynahet, sepse në këtë formë ai mbron besimin, nderin, moralin dhe dinjitetin e tij.

Në të kundërtën, njeriu do të rrezikonte shumë besimin e tij, sepse siç dhe thuhet nga dijetarë të shumtë; "çdo gjynah është një rrugë për në mosbesim".

Këtë na e pasqyron i dërguari I Allahut a.s ku thotë: "Kur robi vepron një gjynah, vendoset në zemrën e tij një pikë e zezë. Në momentin që ky njeri pendohet, atëherë kjo pikë e zezë fshihet dhe pastrohet.

Nëse ai përsëri vepron gjynah dhe është i vazhdueshëm në të, kjo pikë e zezë sa vjen dhe zmadhohet në zemrën e tij dhe e kaplon të gjithë atë. Më pas i dërguari i Allahut (a.s) shton dhe thotë: Pikërisht për këtë gjë Allahu i Lartësuar thotë në Kuran "Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat. (Mutaffifin 14)

(Transmeton Ibn Xherir Taberiu në tefsirin e tij)

Sedd-i dherrâii (سد الذرائع) është një terminologji e përdorur në literaturën islame (Në uslulu fikh të imam Ahmedit dhe Malikut), e cila do të thotë të vendosësh pengesa për gjynahet dhe për të arritur tek diçka më e mirë.

Kjo për vetë faktin sepse Allahu i Lartësuar në Kuranin fisnik përdor termin "Ue le tekrrabu" -dhe mos ju afro x gjynahu (Enam 152, Isra 32).

Kjo bën atë që një mysliman duhet që ti peshojë gjërat në bazë të asaj çfarë thotë feja e Zotit.

Merret situata dhe filtrohet sipas ligjeve islame.

Nuk filtrohen ligjet e Kuranit në bazë të situatës, nuk përshtatet Kurani sipas situatës, por situata duhet të dali në konkluzionin përfundimtar sipas Kuranit.

Prandaj kur dikush përballet me një vepër e cila është haram, ai nuk ka aspak medyshje nga mënjanimi I saj, sepse është plotësisht i bindur se ai gjynah mund të bëhet shkak për zemërimin e Zotit, por dhe nga ana tjetër është plotësisht i bindur se largimi nga ai gjynah mund të bëhet shkak për kënaqësinë e Zotit, ku si shpërblim arrinë gradë të lartë në dynja dhe ahiret.

Që të mos arrihet tek gjynahu, atëherë mund të ketë disa veprime parandaluese të cilat e mbrojnë besimtarin që të mos përfundojë në

veprim të diçkaje të gabuar.

Mund të sjellim disa shembuj si më poshtë:

Mund të sjellim si shembull historinë më të bukur të cilësuar nga Kurani Fisnik, atë të Jusufit (a.s);

-Ai në momentin që u përball me gjynahun menjëherë kujtoi mirësitë e Zotit të Tij, ku në fakt të kujtosh mirësitë e Zotit tënd në momentet drejt gjynahut, mund të bëhet një "Sedd-i dherrâi".

Duke qënë afër për të rënë në gjynah, situatën dhe reagiminin e Jusufit (a.s) Kurani e shpjegon kështu: "Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe tha: "Jam e gatshme për ty!" Kurse ai tha: "Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, pa dyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë".(Jusuf: 23)

Jusufi (a.s) jo vetëm këtë reagim, por ai do të kënaqej edhe sikur të burgosej për vite të tëra, por kurrsesi ai mos të binte në një gjynah të tillë. Ai tha: "O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtynjë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua)." (Jusuf: 33)

-Pikë tjetër që duhet të kemi kujdes ndaj gjynaheve është dhe qëndrimi larg atmosferës së gjynaheve.

Allahu thotë kështu: "Dhe mos iu qasni zinasë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar! (Israa: 32).

Pra, qëndro larg çdo dere e cila nëse do të hapet, mbas saj qëndron një humnerë, ku nëse bie do të rrezikosh besimin tënd dhe ahiretin tënd.

Të qëndrosh afër gjynahut do të thotë që herët a vonë do e besh atë. Prandaj këshillon Allahu i Lartësuar në këtë formë, sepse Ai është Krijuesi ynë dhe kush më mirë se Ai e njeh krijesën e Tij.

-Një pikë tjetër pengesë për gjynahet është shoqërimi me njerëz të mirë, besimtarë.

I dërguari i Allahut a.s këshillon që kur dikush prej jush udhëton, atëherë minimumi të jenë tre veta, sepse në këtë formë mund të bëhen pengesë ndaj njëri-tjetrit për mos të rënë në gjynahe. (Ebu Davud, Tirmidhiu).

-Të shfrytëzosh mirësitë e hallallit në kohën e duhur është një pengesë tjetër për gjynahet. P.sh njeriu e ka hallall të martohet në moshë të re kur ai i plotëson kushtet e nevojshme,

mirëpo nëse ai këtë gjë nuk e aplikon dhe e vonon, atëherë ai është shumë më i ekspozuar drejt nefsit dhe shejtanit të mallkuar që të përdorin epshet e tij dhe kësajsoj të përfundojë në gjynah. Në këtë formë besimtari ruan zemrën e tij nga gjynahet, ku duke ruajtur zemrën ruan besimin e tij.

Punët e zemrës janë një prej punëve aq sa delikate, por aq dhe të rëndësishme për të pasur sukses në të dy botët.

Prandaj nga lutjet më të shpeshta në përditshmërinë e Muhammedit a.s ishte: "O Forcuesi i zemrave ma forco zemrën time në fenë tënde".

Kur Aishja (r.a) e pyet të dërguarin e Allahut se pse ai e thotë kaq shpesh këtë lutje, Ai (s.a.s) përgjigjet: "pa diskutim që zemra e njeriut është midis "dy gishtave të

Allahut", kë do Ai e bën që të devijojë dhe kë do Ai e forcon". (Musnedi i imam Ahmedit ,ndërsa Tirmidhiu e transmeton me dialogun e Enesit (r.a)).

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik shpesh herë na mëson lutje specifike, të cilat në fakt sipas shumë dijetarëve janë lutjet me potencialin më të madh për tu pranuar. Në të njëjtën kohë janë lutjet të cilat plotësojnë të gjitha nevojat e njeriut qoftë të dynjasë qoftë dhe të ahiretit. Duke u lutur me lutjet që Allahu na mëson në Kuran, atëherë do të thotë se i je bindur Zotit tënd i Cili sikur thotë kështu: "lutu me lutjen që Unë të mësoj, sepse jam Unë Ai i Cili të njoh ty më mirë sesa ti njeh vetveten tënde". Nisur nga kjo Ai ma mëson të lutemi kështu: (Ata thonë:) "O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh! (Ali Imran 8)

Të jesh besimtar, të jesh praktikant, të jesh i qëndrueshëm në fe dhe të qëndrosh larg gjynaheve, nuk është gjë tjetër vetëm se një mirësi e madhe e Allahut të Lartësuar kundrejt robërve të Tij.

Allahu na bëftë të qëndrueshëm në fe dhe na largoftë nga gjynahet.

Amin!

Mehmet Disha



FITORE E DRITËS MBI ERRËSIRËN

Hixhreti Profetik

Në fillim të çdo hëne të re të muajit Muharrem, që për këtë vit hyn në datën 19.07.2023 sipas kalendarit gregorian, jetojmë në përkujtimin e hixhretit profetik. Në brendësinë e qenies sonë ngjallet ndjenja e sakrificës dhe idealeve më të larta, shfaqet besimi i pastër, shkreprijnë rrezet e përpjekjeve e kumbon fuqishëm zëri i arsyes dhe i së vërtetës.

Nga mundimet dhe persekutimet e mëdha që përjetonin myslimanët prej idhujtarëve, u detyruan që fshehtas, grupe-grupe ta linin Mekën dhe t'i drejtoheshin Medinës, për të gjetur shpëtim, prehje dhe qetësi, ku do të mundnin lirisht t'i shprehnin ndjenjat e tyre fetare. Mirëpo jobesimtarët i shqetësonte përhapja e dritës. Mundoheshin me çdo mjet e metodë ta shuanin atë. Planet dhe orvajtjet e tyre Profetit ia zbuloi Krijuesi i gjithësisë, Allahu Fuqiptotë, i Cili në Kur'an thotë: **"Përkujto (o i dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin kundër teje; të ngujojnë, të mbysin ose të dëbojnë. Ata bënin plane, e Allahu i asgjësonte, se Allahu është më i miri që asgjëson (dredhitë)."** (Enfal, 8:30)

Kështu, Profeti së bashku me shokun e tij Ebu Bekrin largohen nga Meka. I frikësuar për jetën e profetit, Ebu Bekri do t'i thoshte: "O i Dërguar, nëse të ndodh gjë ty, Islami do të fshihet nga faqja e dheut". Mirëpo si çdo herë, fjalët e Profetit do të ishin si balsam dhe do ta qetësonin Ebu Bekrin: "O Ebu Bekër, çfarë mendon për dy vetë, i treti i të cilëve është Allahu, prandaj mos u dëshpëro dhe mos u frikëso se Allahu është me ne, Ai na mbron dhe

përkujdeset për ne".

Në të vërtetë, ndihma dhe përkrahja e Krijuesit të gjithësisë, e cila asnjëherë nuk u ka munguar robve të Tij të devotshëm, nuk mungoi edhe kësaj radhe. Në Kur'an lexojmë: **"...e kur ata të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të tij: انعم الله علينا ان نخرج آل mos u pikëllo (dëshpëro), Allahu është me ne! E Allahu i zbriti qetësi (prehje) në shpirtin e atij, e furnizoi me një ushtri që ju nuk e patë..."** (Teube, 9:40)

Fjalët e Allahut janë më të lartat, sepse janë të shenjta; janë burim i pashtershëm i së vërtetës, i dritës dhe i udhëzimit; janë baza e moralit të përkryer, ashtu siç janë ideal i përhershëm i rrugës së shpëtimit dhe i fatbardhësisë njerëzore deri në amshim. Kurse fjalët e jobesimtarëve janë të ulëta, të pavërteta, të errëta dhe pa vlerë. Ato çojnë në humbje e në shkatërrim, në zhdukje e degradim. Fjala dhe Drita e Allahut do të plotësohen dhe përhapen pa marrë parasysh mërinë e urrejtjen e idhujtarisë.

Hixhret do të thotë: largim, shpërngulje, kalim, braktisje dhe ndarje nga diçka. Shpërngulja e bekuar e Muhamedit a.s nga Meka për në Medinë, me urdhër të Allahut të Madhëruar, ishte shpërngulje me qëllim kthimi, sepse i dërguari i Zotit, duke dalë nga Meka, me lot në sy tha: "Mekë, o vendlindja ime e shtrenjtë, kurrë nuk do të të kisha lënë, po të mos më detyronin të të lija". Ai kurrë nuk do ta harronte Mekën, derisa e çliroi njëherë e përgjithmonë nga prangat e idhujtarisë.

Kjo u bë e mundur, sepse hixhreti i Muhamedit a.s dhe i



myslimanëve të tjerë, nuk ishte shpërngulje e “bijve dhe e shpirtrave të trazuar” nga frika për jetën e tyre, siç mund të përipiet ta përshkruajë dikush, shpërnguljen e tyre të bekuar.

Hixhreti nuk ishte as ikje e as humbje e së vërtetës para urrejtjes hakmarrëse të jobesimtarëve, por ishte vendosmëri e paluhatshme dhe fillim i një rreshtimi të ri për thyerjen përfundimtare të jobesimtarëve; ishte rrugë e përhapjes dhe shtrirjes së dritës së besimit, dritë të cilën idhujtarët ishin munduar ta pengojnë plot trembëdhjetë vjet, me qëllim që ta zhduknin nga faqja e dheut.

Po qe se hixhreti do të ishte ikje nga frika, besimtarëve nuk do t’u arrinte ndihma dhe përkrahja e Allahut Fuqplotë, sepse Ai nuk i ndihmon dhe as nuk i lartëson frikakakët e të pavendosurit. Allahu dëshiron që besimtarët të jenë të fortë, të paepur e të vendosur në besimin dhe durimin e tyre.

Hixhreti ishte një planifikim i urtë dhe largpamës, ishte fillimi i një beteje ndërmjet dritës dhe errësirës, ishte shpërngulje e njerëzve drejt lirisë, fisnikërisë dhe dinjitetit, ngritje në çiltërsinë e dëlirësinë shpirtërore dhe shpëtim i ndërgjegjeve të pastra.

Hixhreti, në shikim të parë, ishte kalim nga një vend në një vend tjetër, kurse në esencë shpërngulje nga dobësia në fuqi dhe nga pesimizmi në shpresë, për një ardhmëri më të lumtur e më të shndritshme të Islamit.

Për këtë arsye Allahu i Madhëruar ia lejoi hixhretin të dërguarit të Tij. E rezultati nuk vonoi. Puna e parë e

Muhamedit a.s. pas arritjes në Medine, ishte vëllazërimi i myslimanëve - ensarëve (banorëve) të Medines dhe muhaxhirëve (të shpërngulurve) të Mekës, që u pasua nga ndërtimi i xhamisë, e cila do të ishte fanar ndriçues nga ku do të rrezatonin rrezet e dritës së udhëzimit të vërtetë. Në Kur’an thuhet: “Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që ndihmon Atë. Allahu është Fuqplotë dhe i Plotfuqishëm”. (Haxh, 22:40)

Përkujtimi i hixhretit në fillim të çdo viti, na bën më të ndërgjegjshëm për rëndësinë e përpjekjes në rrugën e Allahut, në rrugën e thirrjes në Islam, në rrugën e paqes dhe tolerancës, dashurisë dhe respektit të thellë ndaj çdo njeriu. Na përkujton gjithmonë fitoren e lavdishme të dritës ndaj errësirës, triumfin e besimit ndaj të kotës dhe të keqes.

Besimtarët e ndershëm duhet ta jetojnë hixhretin, duke ruajtur me kujdesin më të madh mesazhin e tij, duke bërë hixhret të vazhdueshëm nga e keqja në të mirë, nga e pavërteta në të vërtetë, nga veprat e shëmtuara në ato të lavdëruara, nga koprracia në bujari, nga zemërngushtësia në zemërgjerësi, nga tradhtia në besnikëri, nga dyfytërsia në sinqeritet e çiltërsi shpirtërore dhe nga robëria e mohimit në lirinë e besimit.

Dorian Demetja



1

FALJA E KURBAN BAJRAMIT NË SHESHIN "SKËNDERBEJ" NË TIRANË

Mijëra besimtarë myslimanë mbushën sheshin "Skënderbej" në Tiranë dhe të gjithë sheshet kryesore të qyteteve dhe xhamitë e vendit për faljen e Kurban Bajramit, me datë 28.06.2023.

Programi i Kurban Bajramit filloi që në orët e para të mëngjesit të ditës në sheshin "Skënderbej", Tiranë, me lexim Kur'ani nga imami i xhamisë "Et'hem Bej", z. Elton Karaj.

Ceremonia vijoi më tej me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli për besimtarët e pranishëm disa nga urtësitë e kësaj feste.

"Kurban Bajrami është një festë madhështore sepse ajo buron nga një akt i pashembullt dashurie, bindjeje dhe durimi i njeriut ndaj Krijuesit të gjithësisë. Nëpërmjet besimit njeriu nuk heq dorë nga asgjë, përkundrazi, nëpërmjet besimit ai merr gjithçka saktësisht në po atë masë që punon për të, madje punët e mira shpërblehen shumëfish." – u shpreh Kryetari Spahiu.

Më tej ai u lut për më shumë solidaritet, paqe e harmoni mes nesh në këtë ditë të bekuar.

Fill pas fjalës së Kryetarit Spahiu, ishte momenti i faljes së namazit të Kurban Bajramit, namaz në të cilin mijëra besimtarët e mbledhur me këtë rast i priu po ai.

Kjo ceremoni u mbyll me hutben e bajramit, hutbe të cilën e mbajti Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica.

Në fjalën e tij, z. Bica, ndau me mijëra besimtarët e pranishëm mesazhe të shumta paqeje dhe solidariteti.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar bashkërisht me familjet dhe të afërmit e tyre.





2

PRITJET E VIZITAVE NË SELINË E KMSH, ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT

Pas përfundimit të ceremonisë së faljes së Kurban Bajramit në Sheshin "Skënderbej" në Tiranë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ashtu si çdo vit tjetër, hapi dyert për të prituri urimet me rastin e kësaj feste.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti urimet nga Kryetarja e Parlamentit, znj. Lindita Nikolla, Ministra e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Elisa Spiropali, Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliq, nga titullarët e komuniteteve fetare të vendit tonë, nga akademikë, drejtues të institucioneve qendrore e lokale, publike e private, personalitete si dhe nga qytetarë të shumtë.

Urimet e tyre i përcollën edhe ambasadorët e vendeve të Bashkimit Europian dhe vendeve të tjera mike, të akredituara në Tiranë.

Në mesazhet e tyre drejtuar Kryetarit Spahiu, ata shprehën urimet dhe përshëndetjet më të sinqerta, si dhe vunë theksin te simbolika e sakrificës dhe solidaritetit që përcjell Kurban Bajrami në vendin tonë dhe mbarë botën.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.





3

NISET GRUPI I PARË I HAXHIJVE DREJT VENDEVE TË SHENJTA, MEKË E MEDINE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me Ambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi, përcollën me datë 19.06.2023 grupin e parë të haxhijve prej 150 besimtarësh në aeroportin e Rinasit.

Në takimin e zhvilluar me ta, Kryetari Spahiu, iu uroi besimtarëve haxh të pranuar si dhe kërkoi nga ana e tyre lutje për mirëqenien morale e materiale të vendit tonë. Ai gjithashtu i siguroi ata për një organizim të denjë nga ana e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Ndërsa Ambasadori, z. Hifdhi, tha se Ministria e Haxhit në Mbretërinë e Arabisë Saudite, ka marrë të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e një rituali sa më të kënaqshëm për besimtarët që do të udhëtojnë drejt vendeve të shenjta për të kryer haxhin këtë vit. Po ashtu, ai uroi besimtarët që të kthehen me haxh të pranuar pranë familjeve të tyre.

Më tej, të dy të lartpërmendurit, iu shpërndanë nga një trëndafil mysafirëve të Zotit.

Këtë vit, ishin rreth 810 besimtarë që u nisën nga Shqipëria për të kryer haxhin.

Allahu (xh.sh) u mundësoftë udhëtim të sigurtë!

4

FILLIMI I HAXHIT PËR MILIONA HAXHIJ

Në datën 26.06.2023, ka filluar haxhi për miliona haxhij nga e gjithë bota, ndër ta edhe mbi 800 haxhij nga Shqipëria kanë mbërritur tashmë në Mina dhe janë akomoduar në çadra.

Me të mbërritur në Mina ata kanë filluar me faljen e namazeve ditore, leximin e Kuranit Famëlartë, si dhe zhvillimin e ligjëratave të ndryshme në lidhje me ato gjëra që praktikohen më së shumti gjatë vizitës së këtyre vendeve të shenjta.

Pas përfundimit të qëndrimit në Mina, ata do të vazhdojnë udhëtimin e tyre drejt Arafatit.

Allahu (xh.sh) pranofte prej tyre çdo adhurim e lutje!





5

NË PRITJE TË DITËS SË ARAFATIT

Në mesin e miliona besimtarëve të mbledhur nga e gjithë bota, në malin e arafatit janë mbledhur qendrojnë edhe haxhijtë shqiptarë. Qëndrimi në Arafat është një nga kushtet themelore të ritualeve të haxhit. Nisur nga kjo, Prof. Xhemal Seferti, mbajti një ligjëratë kushtuar vlerës dhe veçorive të kësaj dite.

Po ashtu, haxhijtë shqiptarë falën bashkërisht namazin e drekës, atë të ikindisë si dhe po angazhohen me lexim Kur'ani dhe dua deri në kohën e akshamit.

Allahu (xh.sh) pastë pranuar prej tyre çdo lutje e adhurim!

6

HEDHJA E GURËVE NË XHEMARAT

Pas rikthimit në hotel ku janë të akomoduar në Mekë, haxhijtë shqiptarë, në mënyrë të organizuar hodhën gurët e ditës së dytë në Xhemarat. Hedhja e gurëve në Xhemarat simbolizon goditjen e shejtanit.

Pikërisht në këtë vend ku haxhijtë nga e gjithë bota vijnë dhe godasin me gurë shejtanin (të keqen), ky i fundit i është shfaqur Ibrahimit (a.s), i cili e goditi atë me gurë

Nisur nga kjo simbolikë, ky vend është bërë prej kushteve të haxhit, kusht të cilin e praktikuan edhe haxhijtë Shqiptarë në të dyja ditët që pasuan haxhin.



Thelasi

**ËSHTË THELBI DHE SHPIRTI
I VEPRAVE TUAJA**

Riaja do të thotë të mos jesh një në thelb, të mos veprësh ashtu siç beson, të jesh hipokrit, të bësh gjëra të mira që bëhen për adhurim dhe bamirësi që të tregohesh dhe të pëlqesh nga të tjerët. Riaja është një sjellje shumë e rrezikshme që bën që të gjitha veprat e mira dhe ibadetet t'u përplasën për fytyrë njerëzve, që do të thotë t'i bësh shok Allahut dhe i çon njerëzit në dënimin më të madh.

Pothuajse të gjithë njerëzit në përgjithësi kanë ndjenjën e të qenit në zemrën e njerëzve të tjerë, kuriozitetin dhe dëshirën për t'u dukur e quajtur famë, prirjen për të tërhequr vëmendjen në shoqëri, për të pasur një pozicion pak a shumë.

Riaja është burimi i shumë sjelljeve të këqija dhe damari më i dobët i njerëzve. Thelbi i riasë është të paraqitesh hipokrit për të fituar një vend në mesin e njerëzve në zemrat e tyre, duke pritur kështu respekt dhe nder për t'u siguruar që ata të trajtohen mirë. Njerëzit hipokritë janë të papëlqyer dhe të dënuar në sytë e Allahut. Për të tillët Allahu ka thënë: *"Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm (të harrueshëm), e veprajnë, vetëm sa për sy e faqe (para botës)"* (Ma'un, 107/4-6)

Hipokrizia nuk është kurrë një vepër e një besimtarit. Allahu e përshkroi hipokrizinë si zakon të "munafikëve-hipokritëve" dhe thotë: *"Me të vërtetë, hipokritët përpiqen ta mashtrojnë Perëndinë, por ai i mashtron ata (i dënon). Kur ata ngritën për namaz, ngriten pritueshëm, duke u paraqitur karshi botës (që janë besimtarë), e Perëndinë e përmendin pak herë."* (Nisa, 4/142)

Muslimanët nuk duhet të jenë kurrë hipokritë në asnjë nga çështjet e tyre. Sepse, ashtu si shiu shkatërron tokën në një shkëmb, hipokrizia shkatërron të gjitha veprat dhe ibadetet e mira. Arsyeja është se bëhet për t'u treguar njerëzve në vend të qëllimit për të fituar pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut në adhurim dhe mirësi. Allahu i Madhëruar i përshkruan vepra të tilla në ajetin vijues: *"O besimtarë! Mos e shëmtoni të mirën e lëmoshës suaj me reklamacion dhe fyerje, siç vepron ai që shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës,*

e nuk beson në Perëndinë dhe Ditën e Kijametit, Ai i gjason gurit të lëmuar, në të cilin ka pak dhé. E, kur shiu i bie rrëbesh, e zhveshë atë dhe e le gur të thatë. (Hipokritët), nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë. Se, Perëndia nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues." (Bekare, 2/264)

I Dërguari i Allahut (a.s) e krahasoi hipokrizinë me shirkun e vogël për shkak të qëllimit të tij dhe tha: "Allahu tha; "Unë jam më i vetëmjaftueshmi dhe më i lartësuar nga politeizmi i politeistëve. Kush më shoqëron me të tjerët (me rija) në veprën dhe adhurimin e tij, unë do ta lë atë person vetëm me veprën që ka ndarë me mua ose me ortakun e tij (i heq shpërblimin e veprave të tij)."¹

Kundërhelmi për rija është sinqeriteti. Përderisa besimtarit është i sinqertë, ai e mban veten larg humnerës së hipokrizisë. Ebu'l-Lejth es-Samerkandi, një nga miqtë e Allahut, tregon: "Gjendja e atyre që adhurojnë për qëllime të tjera përveç kënaqësisë së Allahut është si një njeri që mbush xhepin me guralecë dhe shkon në treg. Kur njerëzit e shohin çantën e tij plot nga larg, "Sa njeri i pasur!" thanë ata. Nuk ka asnjë përfitim për të, përveçse t'i thuhet kështu për të. Po të donte të blinte diçka nga pazari, askush nuk do t'u jepte guralecëve në çantën e tij.

Fitimi i një njeriu që bën vepra pa sinqeritet është një barrë e kotë mbi kurrizin e tij, hipokrizi e paefektshme dhe e pavlefshme në sytë e njerëzve dhe mundim i madh.

Në lidhje me këtë tregohet një ngjarje: "Një beduin falet me nxitim në xhami. Khalifë Umer, i cili vëzhgon situatën, donte t'ia tërheq vëmendjen.

– O rob i Allahut, çfarë namazi është ky? Ashtu si një pulë ha ushqim. Më mirë, përsërisni atë namaz!

Burri e bën përsëri. Por si e bën atë? Pa nxitim, duke përsosur të gjitha rregullat.

Khalifë, duke parë situatën, e pyeti pas namazit:

– Më thuaj tani, cili namaz ishte më i mirë?

Burri përgjigjet:

– Namazi ime e parë ishte më e mirë?

– Pse?

1. Muslim, Zuhd, 46.

– Sepse, thotë ai, e bëra vetëm për hir të Allahut, ndërsa këtë të dytën e bëra nën mbikëqyrjen tuaj, për hir tuaj!”

Njeriu duhet të bëjë qëllim kryesor në veprat e tij vetëm kënaqësinë e Allahut, as të mos mendojë për shikimin apo admirimin e të tjerëve rreth tij dhe duhet t’i kushtojë kujdes farzit, vaxhibit dhe suneteve të tij.

Mirëpo, dispozita se nuk ka hipokrizi në farzet është e prerë. Faluni kudo që të jetë dhe mos e mbani mendjen te hipokrizia. Në këtë periudhë, kur njerëzit janë thellësisht të pavëmendshëm, namazi duhet falur pothuajse kudo pa hezitim dhe duhet të jetë një rast për ndërgjegjen e atyre që e shohin. Në këtë gjendje, besimtari mendon për pëlqimin e Zotit të tij dhe ata dëgjojnë zërin e ndërgjegjes së tyre.²

Mirësia e veprimit varet nga vitaliteti i tij. Thelbi dhe shpirti i veprës është sinqeriteti. Sinqeriteti është emri dhe titulli i të vepruarit si dhurues dhe jo si kreditor në sjelljen tonë ndaj Zotit tonë, me fjalë të tjera, të mos kemi asnjë pritshmëri kur bëjmë punë për hir të Allahut.

Sinqeriteti nuk do të thotë vetëm të punosh për hir të Allahut, por edhe të mbyllësh dyert e zemrës ndaj të gjitha pritjeve të tjera. Të mos jesh në gjendje të kalosh përpara pritshmërive përveç përmbushjes së obligimeve, do të thotë ndotje e veprave. Është për shkak të kësaj fuqie të fshehtë të sinqeritetit që Profeti tha: “Bëhu i sinqertë në jetën tënde fetare, mjaftojnë disa vepra”³ dhe tha: “Gjithmonë respektoni sinqeritetin në veprat tuaja; sepse Allahu pranon vetëm veprën e sinqertë”⁴ duke këshilluar që veprat të jenë në kriterin e sinqeritetit.

Pra, gjithçka duhet të jetë për Zotin tonë të Plotfuqishëm, duhet të jetë vetëm Ai, jo ne vetë, që shprehet në të gjitha gjendjet tona.

Ikhlasit gjithashtu ka gradat e veta. Secili mund të gjejë një horizont sinqeriteti sipas nivelit të tij të ibadetit. Miqtë e Allahut e kanë ndarë këtë në tri kategori kryesore.

Në shkallën e parë vjen sinqeriteti i Pejgamberëve dhe i dijetarëve, të cilët e kaluan jetën në hijet e tyre si trashëgimtarë të pejgambereve. Anëtarët e këtij grupi nuk kanë ndonjë pritshmëri të kësaj bote apo të botës tjetër.

Ata janë përfaqësuesit e një horizonti të lartë që është pothuajse e pamundur të arrihet dhe sytë e të cilit janë të ngulur vetëm në pëlqimin e Allahut.

Miqtë e tjerë të Zotit zënë vendin e dytë. As përfaqësuesit e këtij grupi nuk kanë pritshmëri të kësaj bote. Megjithatë, bukuria transhendente e Xhennetit dhe gjendja e Xhehenemit që tmerrojnë mendjet, i paralajmërojnë këta njerëz se presin të falen në Ditën e Gjykimit dhe dëshira për të arritur lumturinë e përjetshme zë vend në zemrat e tyre.

Ata që zënë vendin e tyre në grupin e tretë dhe të fundit kanë dëshirën për xhennet, mendimin për të qenë larg xhehenemit, por kanë edhe disa pritshmëri të botës sipas nivelit të tyre. Të tilla si ndjesia e kënaqësisë shpirtërore gjatë adhurimit, të qenit i kënaqur me kënaqësitë shpirtërore, shijimi i asaj kënaqësie të vendosur në shërbim gjatë vrapimit në rrugën e Zotit.

Përndryshe, pritshmëritë si të pasurit apo të fitojnë famë nuk mund të gjejnë vend për veten as në hijet e këtyre njerëzve.

Përndryshe, ‘më lejoni të shijoj kënaqësinë e adhurimit me anën e tij të kësaj bote, të shijoj kënaqësinë e vrapimit në rrugën e Allahut dhe të bëhem i njohur duke i udhëzuar njerëzit drejt së Vërtetës. Me atë që i takon akhiretit, mendimet dhe pritjet si vdekja ime le të jetë e lehtë, varri im bëhet kopsht me lule, do të jem i mbrojtur nga tmerret e ringjalljes, do t’i shpëtoj të njohurit e mi me ndërmjetësim’... janë shenjat se ne ende nuk mund ta shpëtojmë veten nga graviteti i mishit.

Përktheu Haki Sahitaj

2. Ahmed Şahin, Olaylar Konuşuyor, fq. 78.

3. Munâvî, Fejzu'l-Kadîr, 1/216.

4. Munâvî, Fejzu'l-Kadîr, 1/217.



QËNDRUESHMËRIA

NË

Islam

Sufjan bin Abdullahu tregon: E pyeta të dërguarin e Allahut a.s.: "O i dërguari i Allahut! Më mëso diçka nga Islami për të cilën nuk do të kem nevojë të pyes të tjerët. Ai më tha: "Thuaj besova Zotin, pastaj bëhu i qëndrueshëm në kryerjen e veprave të mira."¹

Sahabiu i nderuar kërkoi nga Profeti a.s. që t'i mësonte diçka përmbledhëse rreth Islamit, në mënyrë që ai mos të kishte më nevojë të pyeste të tjerët rreth tij. Profeti a.s. i tha: "Thuaj besova Zotin", domethënë, ripërtërije besimin tënd tek Allahu me zemër dhe me gojë, që të mbash gjithnjë parasysh të gjitha kuptimet e Islamit dhe të Imanit. Pastaj i tha: "Bëhu i qëndrueshëm në kryerjen e veprave të mira", domethënë trego kujdes që të zbatosh urdhërat e Allahut dhe të mos i shkelësh ndalesat e Tij.

Në Kur'anin famlartë fjala el-istikame përmendet afërsisht 49 herë.

Fjala el-istikame në kuptimin gjuhësor do të thotë: mosshtrëmbërim, mosmënjanim. Kurse për sa i përket kuptimit të kësaj fjale si term fetar, Ibn Rexheb el-Hanbeli thotë: El-Istikame është ndjekja e rrugës së drejtë, fesë së qëndrueshme... Ajo përfshin kryerjen e të gjitha detyrave fetare publike dhe jo-publike dhe braktisjen e të gjitha ndalesave të tilla.²

Vepra që e ndihmojnë njeriun të jetë i qëndrueshëm në fe:

1- Leximi i Kur'anit dhe përpjekja për ta kuptuar atë sa më mirë.

2- Besimi në Allahun dhe veprat e mira. Zoti xh.sh. thotë:

"Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër."³ Katade në komentimin që i bën këtij ajeti, thotë: "Në këtë botë i forcon me vepra të mira, ndërsa në botën tjetër i forcon në varr."

3- Meditimi rreth tregimeve profetike. Allahu xh.sh. thotë: "Ne po t'i tregojmë ty disa nga historitë e të dërguarve, për të ta forcuar zemrën."⁴

4- Lutja (dua'ja). Prej cilësive të besimtarëve të mirë është se ata i drejtohen Allahut me lutje, duke kërkuar që Ai t'i forcojë në fenë e Tij.

Allahu në Kur'an na tregon mënyrën se

1. Muslimi.

2. Xhamiu'l-Ulum uel-hikem.

3. Ibrahim, 27.

4. Hud, 120.

si luten besimtarët: "Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë..."⁵

Pejgamberi a.s. shpeshherë lutej me këto fjalë: "O Allah, që ndryshon drejtimin e shikimit dhe të zemrës, të kërkoj që ta forcosh zemrën time dhe ta bësh të qëndrueshme në fenë Tënde!"⁶

5- Dhikri (Përmendja e Allahut). Allahu xh.sh. thotë: "...Vërtetë, zemrat qetësohen duke përmendur Allahun!"⁷ Pejgamberi a.s. ka thënë: "Shembulli i atij që e përmend Allahun dhe atij që nuk e përmend, është si shembulli i të gjallit me të vdekurin."⁸

6 - Bëj diçka për Islam. Nëse dëshiron të jesh i qëndrueshëm, jep edhe ti kontributin tënd përfenë. Zoti xh.sh. thotë: "O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."⁹

7- Shoqëria e mirë. Zgjedhja e shoqërisë së mirë e ndihmon njeriun të qëndrojë në rrugën e drejtë. Allahu i madhëruar thotë: "Qëndro me ata që i luten Zotit të tyre në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar kënaqësinë e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e kësaj jete..."¹⁰

Ukbe ibn Meit ishte një nga kundërshtarët më të egër dhe të pamëshirshëm të Profetit a.s. Ai e trajtonte shumë keq Profetin a.s., e fyente dhe e poshtëronte para gjithë njerëzve. Ky njeri mbeti i varur në betejën e Bedrit. Ndoshta është e çuditshme, por ky njeri gati sa nuk e pranoi Islam. Shkaku që e shtyu të largohej nga ky vendim dhe kjo dëshirë, është shoku i tij Ebu Xhehli. Kur filloi të ndjejë diçka për Islam, ai shkoi dhe i tregoi Ebu Xhehlit. Me ta dëgjuar, Ebu Xhehli i tha: "Miqësisë sonë i vjen fundi, nëse nuk shkon te Muhamedi dhe ta pështysh në fytyrë".

Ukbe u mat njëherë dhe peshoi mes miqësisë me Ebu Xhehlin dhe ndjekjes së Profetit a.s. dhe zgjodhi miqësinë me Ebu Xhehlin. Jo vetëm kaq, por e vuri në zbatim dhe kërkesën e tij. Në fund, ai vdiq si jobesimtar.

5. Al'Imran, 8.

6. Ahmedi.

7. Ra'ad, 28.

8. Buhariu.

9. Muhamed, 7.

10. Kehf, 28.

Disa nga dobitë e qëndrueshmërisë

1. Qetësia shpirtërore. Allahu i Lartësuar në Kur'an thotë:

"Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!"¹¹ Njeriu në këtë botë goditet nga sprova të ndryshme dhe fatkeqësi që ia bëjnë jetën të vështirë, mirëpo në qoftë se ai është i qëndrueshëm në fenë e Allahut, i zbaton urdhrat e Tij dhe shmanget nga ndalesat e Tij, kjo gjë e bën atë të qetë shpirtërisht, sepse lidhja e tij me Zotin dhe mbështetja e Tij në Të është shumë e fortë. Kjo lidhje ia largon atij zymtësinë, pikëllimin dhe brengat dhe bën që Allahu t'ia heqë brengat dhe t'ia shndërrojë pikëllimin në gëzim e lumturi.

2. Bereqeti në pasuri. Allahu i Madhëruar thotë: "Sikur të qëndronin (banorët e Mekës) në rrugën e vërtetë, Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm"¹² Në këtë ajet kuranor Allahu na tregon për një ndër frytet e qëndrueshmërisë në fe, që është bereqeti dhe bollëku në pasuri. Pra Zoti u premtoi atyre që janë të qëndrueshëm në fenë e Tij në këtë botë se do t'ua hapë dyert e

11. Ra'd, 28.

12. Xhinn, 16.

furnizimit.

3. Mbrojtja nga kurthet e armiëve. Zoti xh.sh. thotë: "...nëse ju duroni dhe ruheni nga gjynahet, dinakëritë e tyre nuk mund t'ju dëmtojnë aspak. Vërtet Allahu ka dijeni për çdo gjë që punojnë ata."¹³ Allahu Fuqiplotë i udhëzoi robërit e Tij besimtarë të jenë të durueshëm, të qëndrueshëm, të ruhen nga gjynahet dhe të mbështeten gjithnjë në Allahun, në mënyrë që Ai t'i shpëtojë nga keqbërësit dhe kurthet e armiëve.

4. Hyrja në xhenet. Prej fryteve të qëndrueshmërisë në fe është fitimi i xhenetit, të cilin Allahu ua premtoi robërve të Tij të devotshëm, ashtu siç thuhet në Kur'an:

"Me të vërtetë, atyre që thonë: "Zoti ynë është Allahu", e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: "Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Gëzojuni xhenetit që ju është premtuar."¹⁴

Naim Drijaj

13. Al'Imran, 120.

14. Fussillet, 30.



PROFETI YNË FTON NJERËZIT NË ISLAM DUKE SHËTITUR RRUGË MË RRUGË E PAZAR MË PAZAR

Rabia bin Ubadi ka thënë: Gjatë kohës së injorancës, e pashë njëherë të Dërguarin e Allahut në pazarin e Dhul-Mexhazit, teksa u thoshte njerëzve:

- *"O njerëz! Thoni 'La ilahe illallah', që të mund të shpëtoni."* Dhe njerëzit e mbledhur përreth tij sa vinin e shtoheshin edhe më shumë. Nga pas i vinte një burrë me dy gërsheta të bukura, me sytë pak me defekt, por fytyrën të shndritshme, që i vinte nga pas dhe thoshte:

- "Ai është një gënjeshtar, që ka braktisur fenë e të parëve të tij!" Pyeta, se kush ishte ky njeri: "Më thanë, ky është xhaxhai i Tij, Ebu Lehebi."¹

Në një tjetër transmetim të këtij hadithi, ka edhe një informacion tjetër, që është i rëndësishëm: "I Dërguari i Allahut i ikte Ebu Lehebit, ndërsa ky gjente çdo mundësi për ta ndjekur nga pas." Ndërsa, një tjetër transmetues e paraqet asisoj, që, në të mund të gjejmë edhe këtë shprehje: "Rreth të Dërguarit të Allahut ishin mbledhur aq shumë njerëz, saqë dukej sikur do të shkelnin njëri-tjetrin. Nuk kisha parë ndonjëherë një njeri që të fliste kaq bukur pa e ndërprerë fjalën."²

Tarik bin Abdullahu rrëfen: "Një ditë, teksa gjendesha në pazarin e Dhul-Mexhazit, pashë një burrë të veshur me një triko të kuqe, i cili po fliste: "O njerëz! Thoni 'La ilahe illallah', që të arrini shpëtimin." Nga pas i rrinte një burrë, i cili i kishte këmbët dhe gjunjët të mbuluar nga gjaku. Ai u thoshte njerëzve: "O popull! Ai gënjen, mos ia vini veshin." Shkova dhe e pyeta, se përse thoshte kështu: "Ai është një djalosh nga bijtë e Hashimit; pretendon se është profet i Allahut, ndërsa ai tjetri është xhaxhai i tij, Ebu Lehebi, rob i idhullit të Uzës."³

Një burrë nga fisi i Malik bin Kīnanes tregon: "Në tregun e Dhul-Mexhazit pashë të Dërguarin e Allahut, i cili shëtiste nëpër të dhe thoshte këto fjalë: *"O njerëz! Thoni 'La ilahe illallah', që të arrini shpëtimin."* Ndërkohë, Ebu Xhehli e godiste me grushte balte dhe thoshte:

- "Ky njeri kërkon që t'ju largojë prej fesë suaj! Kërkon që t'ju shthurë! Ai po ju kërkon të braktisni zotat tuaj, zotat e Latit dhe të Uzës!" Ndërkohë, i Dërguari i Allahut as që i kthente fare sytë nga ai."

Transmetuesi thotë: Unë i kërkova atij njeriu që të ma përshkruante njëherë të Dërguarin e Allahut. Ai më tha: "Ai është një me trup mesatar, por të mbushur, që vesh një triko të kuqe; fytyrën e ka të bukur, flokët shumë të zinj e të dendur, ndërsa lëkurën e ka të bardhë."⁴

PROFETI YNË FTON TË AFËRMIT E TIJ NË ISLAM

Profeti ynë i fton të afërmit e tij në një gosti, për t'u bërë atyre thirrje që të pranojnë fenë e Islamit

Në një transmetim që vjen prej Aliut (radjallahu anhu) thuhet: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i ftoi të gjithë bijtë e Abdulmutalibit në një gosti. Bëheshin diku te dhjetë vetë. Secili prej tyre mund të hante deri në një qengj të pjekur më vete dhe mund të pinin më shumë se shtatë-tetë litra çdonjeri. Ndërsa i Dërguari i Allahut kishte gatuar vetëm një tenxhere me ushqim

për të gjithë. Hëngrën të gjithë, derisa u ngopën. Ndërkohë, ushqimi ishte ende në tenxhere, sikur të mos ishte zënë fare me dorë. Në fund, i Dërguari i Allahut kërkoi diçka për të pirë në një gotë të vogël. Piu prej saj, derisa shoi etjen. Prapëseprapë, pija ishte ende në gotë, sikur të mos kishte pirë asgjë. Paskëtaj, i Dërguari i Allahut tha:

- *"O bijtë e Abdulmutalibit! Zoti më ka dërguar mua si profet, si për ju, ashtu edhe për mbarë njerëzimin. Këtu ju i patë vetë edhe mrekullitë e begatisë së Allahut (xhel'le xhelaluhu). Kush nga ju do të më japë besën, se do të jetë edhe vëlla edhe shok me mua?"*

Asnjë nuk u ngrit në këmbë. Megjithëse unë isha më i vogli, u ngrita unë.

- "Ti ulu", - më tha mua i Dërguari i Allahut. Mandej e përsëriti edhe plot tri herë të tjera pyetjen.

Çdo herë i vetmi që ngrihej isha unë, ndërsa Ai më thoshte të ulesha. Herën e fundit, nuk më tha gjë, por e vuri dorën time pranë dorës së tij dhe e pranoi besëlidhjen."⁵

PROFETI YNË I FTON NJERËZIT NË ISLAM GJATË UDHËTIMEVE

Profeti ynë fton në Islam një beduin

Ibni Omeri (radjallahu anhu) tregon: "Gjatë një udhëtimi në ishëm bashkë me të Dërguarin e Allahut. Rrugës u përballëm me një beduin. Kur iu afrua, i Dërguari i Allahut e pyeti atë njeri se ku po shkonte. Beduini iu përgjigj: - "Jam duke shkuar për te familja ime."

- *"A do që të bësh një të mirë?"*, - e pyeti i Dërguari i Allahut.

- *"Çfarë të mire?"*, - u përgjigj beduini.

- *"A mund të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, se Ai nuk ka as shok, as ortak në krijim dhe se Muhamedi është rob i Dërguarit i Tij?"*

- "Po ti, a ke ndonjë provë se fjalët e tua janë të vërteta?"

- *"Ja, kjo pemë, edhe ajo ka për të dëshmuar se unë po të them të vërtetën."*

I Dërguari i Allahut e thirri atë pemë, e cila gjendej në anën e djathtë të luginës. Pema lëvizi nga vendi dhe qëndroi përpara të Dërguarit Fisnik të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Resulullahu e bëri që të dëshmonte për vërtetësinë e profetësisë së tij për tri herë me radhë atë pemë. Kësisoj, pema dëshmoi për të Dërguarin e Allahut, se ai po thoshte të vërtetën dhe u kthye prapë te vendi i saj. Ai beduin, teksa po kthehej për te familja e tij, po thoshte këto fjalë: "Nëse do të ma dëgjojnë, unë do t'i sjell të gjithë tek ti. Nëse nuk më dëgjojnë, atëherë unë do të vij tek ti i vetëm, e të qëndroj këtu bashkë me ty."

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"

M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH

1. Ibni Kethir, el-Bidaje 3/41.

2. Hejthemi, Mexhmeu'z-Zeuaid 6/20 (9834).

3. Hejthemi, Mexhmeu'z-Zeuaid 6/20 (9835).

4. Ibni Kethir, el-Bidaje 3/139.

5. Ibni Kethir, Tefsir 3/350.

Detyrat e Zemrës



Zemra, si administruesi i qenies sonë shpirtërore, sëmuret po ashtu si edhe organet e tjera. Gjendjen e shëndoshë ose të sëmurë të zemrës e kuptojmë nga defektet dhe simptomat përkatëse.

Çdo organ i trupit tonë ka një detyrë të posaçme. Kur sëmuret një organ, do të thotë se nuk e kryen detyrën që i takon, ose funksionon me të meta. Po kështu, sëmundja e zemrës kuptohet ngaqë s'e kryen detyrën e saj.

"Unë i krijova xhindet dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë Mua." (Kur'ani, Dharijat, 51/56)

Me këtë detyrë zemra na veçon ne prej kafshëve, sepse epërsia e njeriut qëndron te detyrat e zemrës, kurse detyrat trupore për të ngrënë, për të pirë e të tjera si këto, janë më me shumicë te kafshët.

Veprimtarinë e zemrës së njeriut mund ta përmbledhim kështu: ta dijë e ta njohë materien. Nuk ka dyshim se Allahu i Lartë është Krijuesi i materies. Në këto kushte, aftësia e vërtetë është të njohësh Allahun xh.sh. Por njohja e Allahut ka shenjat e veta. Ai që e njeh Allahun xh.sh., e do Atë. Ai që e njeh Allahun, mbahet me sinqeritet rreth urdhrave të Tij. Ai që e njeh Allahun, tregon respekt për krijesat e Tij.

Treguesi më i qartë i dashurisë për Allahun është të mos parapëlqesh para Tij pasuri, fëmijë dhe gjëra të tjera të kësaj bote, e thënë ndryshe, asgjë tjetër përveç Tij. Mes këtyre "asgjë tjetër" janë ata që duam më shumë, nëna, babai, fëmijët... Kuptimi i një ajeti lidhur me këtë specifikë është kështu:

"Thuaj: Po qe se etërit, djemtë, vëllezërit, fisi juaj, pasuria që keni shtënë në dorë, tregtia që keni frikë se mos ju mbetet në vend, banesat që ju japin kënaqësi janë më të shtrenjta e më të dashura se Allahu, se Pejgamberi i Tij dhe se përpjekja në rrugën e Tij, prisni gjersa të vijë ndëshkimi i Allahut. Allahu nuk vë në rrugë të drejtë njerëzit e prishur." (Kur'ani, Teube, 9/24)

Atëherë, zemra që dashuron diçka më tepër se Allahun, është e sëmurë. Kjo i përngjet një stomaku që s'e pëlqen bukën, ndërsa kënaqet me baltën. Ja, kjo është simptoma e sëmundjes së zemrës. Me fjalë të tjera, të duash më shumë se Allahun diçka tjetër të gjallë ose jo, ta parapëlqesh atë ndaj urdhrave, fesë dhe librit të Allahut...

Duhet të themi edhe këtë që kjo sëmundje është shumë e fshehtë. Njeriu s'e dallon

aq lehtë; edhe po e dalloj, kurimi i saj është shumë i vështirë, sepse mjekimi fillestar i sëmundjeve të zemrës është që njeriu të dalë kundër kërkesave e dëshirave të veta. Dhe kjo nuk është një gjë e lehtë. Mjekët e kësaj sëmundjeje janë dijetarët e fesë. Mirëpo, nëse edhe mjekët kapen nga e njëjta sëmundje, puna vështirësohet krejtësisht.

Thamë se mjekimi i zemrës së sëmurë bëhet duke braktisur të gjitha dëshirat dhe epshet. Le ta sqarojmë me shprehjen e tij edhe ca këtë fjalë të Gazaliut, i cili, me zemrën dhe mendjen, mbart një vlerë të madhe në fushën e psikologjisë së fesë.

Le ta pranojmë se sëmundja jonë është koprracia. Këtë do ta mjekojmë me të kundërtën e saj, me bujarinë. Mirëpo, edhe në bujari shkojmë përpara, e kalojmë masën dhe nazë sëmundjaeshpërdorimit. E rëndësishme është të gjejmë mesin e të dyjave. Po qe se egoja jonë është shtënë pas grumbullimit të mallit dhe parasë, kjo do të thotë se ne vuajmë nga sëmundja e koprracisë. Për ta kuruar këtë, do të vazhdojmë të japim. Në këtë mes, do ta mbajmë nën vëzhgim veten tonë. Në qoftë se një ditë do të shfaqet te ne simptoma e të shtënit pas dhënies së tepërt e pa vend, do të jemi kapur nga sëmundja e shpërdorimit (israfit). E në këtë çast duhet të tërhiqemi pak.

Ja pra, kështu, duke ia dhënë për t'i shijuar egos sonë gjërat e kundërta, duhet ta sjellim atë në një gjendje të tillë që, më në fund, zemra të mos ndiejë më pasion për të grumbulluar apo shpenzuar pasuri. Kur të jemi ngjitur në këtë nivel, pasuria dhe paraja bëhen për njeriun diçka e zakonshme, shpenzohet atëherë kur duhet e mblidhet atëherë kur duhet. Zemra e shndërruar kështu, është kthyer në gjendje normale.

Nuk ka dyshim se ky moment është mjaft delikat dhe i rëndësishëm. Kjo është një urë "më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata". Kalimi i kësaj ure në botë është argumenti dhe shenja e parë e kalimit të Urës së Siratit në jetën tjetër. Prandaj në pesë kohët e namazit që falim çdo ditë, lutemi kështu para Allahut:

"Zoti ynë, na drejto në rrugën e drejtë, mos na ndaj nga rruga e drejtë!"

Dr. Bekir Topaloglu

Dita e Ashuras

VLERA DHE MIRËSIA

Dita e Ashuras është një ndër ditët e shënuara të kalendarit islam, e cila vlerësohet nga myslimanët dhe me anë të së cilës adhurojnë dhe i afrohen Zotit. Adhurimi më i spikatur këtë ditë është agjërimi, pasi kjo ditë radhitet te ditët më të vlefshme dhe që shpërblehen më shumë se ditët e tjera të vitit. Kushdo që agjëron këtë ditë, i fshihen gjynahet e vitit të kaluar.

Allahu e ka bërë ndryshimin e ditës dhe të natës argument të qartë e pashmangshëm të ekzistencës dhe fuqisë së Tij absolute. Në këto ditë-net ruhen punët tona e "Kush punon ndonjë të mirë që peshon sa grimca atë do të gjejë dhe kush punon ndonjë të keqe sa grimca atë do të gjejë." (Zelzeleh, 7-8).

Vlen të përmendim se vende apo kohë të bekuara janë vetëm ato të përcaktuara nga Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.). E në bazë të argumenteve muaji Muharrem është dalluar në krahasim me muajt e tjerë të shenjtë për

këto arsye;

Ky muaj është i emërtuar me emër islam, ndërsa muajt e tjerë kanë mbetur me emrat e tyre të mëparshëm.

Me këtë muaj fillon viti hënor që myslimanët e dinë shumë mirë fillimin dhe mbarimin e tij, sepse me të është lidhur vetë feja e tyre.

I Dërguari i Allahut e ka cilësuar këtë muaj duke thënë: "...Muaji i Allahut, Muharrem"¹

Një cilësim i tillë nuk përmendet për ndonjë muaj tjetër. Dihet se pak prej krijesave Allahu i ka cilësuar "të Allahut" në shenjë nderimi kur dihet se të gjitha krijesat janë të Allahut.

Agjërimi në këtë muaj është më i dashur tek Allahu se sa në çdo muaj tjetër. "Agjërimi më i mirë përveç Ramazanit, është agjërimi i muajit të cilin e emërtoni Muharrem."²

-Në të ndodhet dita e Ashuras, dita e dhjetë e muajit për të cilën janë transmetuar hadithe të posaçme.

1. Transmeton Muslimi

2. Transmeton Nesai

Ç'është Ashura?

Ashura është dita e dhjetë e muajit Muharrem sipas mendimit më të drejtë të dijetarëve myslimanë, bazuar në gjuhën arabe, ngaqë Ashura vjen nga fjala ashara (e dhjeta) dhe në hadithe si "Ashura është dita e dhjetë." (Transmeton Daru Kutni, Bejhakui).

Ashura, triumfi i besimit mbi mohimin

"Kjo është ditë e madhe, në të Allahu i Madhëruar shpëtoi Musain dhe popullin e tij dhe mbyti Faraonin me popullin e tij."³

Ky hadith na kujton një ngjarje e cila ka ndodhur para shumë kohësh, në kohën e Musait a.s. Rëndësinë që Allahu i kushton kësaj ndodhie e tregon fakti që historia e Musait me faraonin e Egjiptit, përmendet rreth 30 herë në Kur'an. Pa dashur ta përmendim në detaje këtë ndodhi (të cilën mund ta lexoni më gjerësisht në Kur'an apo në librat e historisë islame), po ndalemi në disa detaje kryesore.

Armiqësia e Faraonit me Musain ka filluar qysh para se të lindte ky i fundit. Faraonin e njoftojnë se fundi i pushtetit të tij do të vijë nga dora e njërit prej bijve të Israilit (Jakubit biri i Is'hakut, birit të Ibrahimit, paqja e Allahut qoftë mbi ta), i cili ende nuk kishte lindur. Nga frika Faraoni i vriste të gjithë djemtë që lindnin pas kësaj dite. Por Allahu me fuqinë e Tij bëri të mundur që Musain jo vetëm që nuk e vrau, por e konsideroi djalë të birësuar. Kaluan vitet dhe kur Musai i kumtoi shpalljen nga Allahu dhe u solli atyre shumë fakte që ata i shikonin me sytë e tyre, kjo ia shtoi dhe më shumë urrejtjen Faraonit tiran dhe popullit të tij mosbesimtar ndaj Musait dhe popullit të tij që ishin besimtarë. Kur u pa qartë se edhe pas gjithë atyre argumenteve Faraoni me popullin e tij (përveç një pakice) nuk besoi, Musai u urdhërua bashkë me popullin e tij të zhvendosen për në Sham (Palestina, Siria, Libani dhe Jordania e sotme). Kur u informua për këtë Faraoni mblodhi të gjithë ushtrinë dhe iu vu në ndjekje Musait dhe popullit, i cili u gjend në mes detit të Kuq nga njëra anë dhe ushtrisë së Faraonit nga ana tjetër. Por bindja e plotë e Musait se Allahu i ndihmon besimtarët, bëri që deti me lejen e Allahut të hapet. Kur u fut dhe kaloi populli i Musait, pas tij u fut dhe Faraoni me ushtrinë e tij dhe mbetën në të.

Kjo ngjarje e madhe në historinë e njerëzimit ka ndodhur pikërisht në ditën e dhjetë të muajit Muharrem, në ditën e Ashuras. Ndaj dhe myslimanët e kujtojnë dhe e agjërojnë këtë ditë

në shenjë falënderimi për Allahun që i shpëtoi besimtarët nga Faraoni, të cilit nuk i bëri dobi as pasuria e as ushtria e tij.

Vlera e ditës së Ashuras

Ibn Abasi përcjell: "Nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut që t'i kushtojë rëndësi ndonjë dite tjetër ashtu siç i kushtonte rëndësi kësaj dite, Ashuras."⁴

Ndër hadithet profetike përmendim: "Agjërimi i Ashuras shpresoj prej Allahut të m'i falë me këtë agjërim gjynahet e vitit të kaluar."

"Agjërimi i Ashuras është shkak për faljen e gjynaheve të vitit të kaluar."⁵

Agjërimi i kësaj dite para se të bëhej detyrë ramazani ka qenë obligim për myslimanët, e më pas u bë sunet i fortë. Ka pasur prej të parëve tanë të mirë që e agjëronin këtë ditë edhe nëse u qëllonte të ishin në udhëtim.

Mënyrat e agjëritit të kësaj dite

Dijetarët kanë përmendur disa mënyra rreth agjëritit të kësaj dite:

- Të agjërohet një ditë përpara dhe një ditë pas, kjo duke u nisur nga dy arsye; a) e para bazuar në hadithin e transmetuar i Ibn Abasit: "Agjëroni Ashuran, e mos përngjasoni me çifutët, por agjëroni një ditë para e një ditë pas"; b) duke u nisur nga pasiguria e qenies atë ditë apo jo, pra për të qenë më të sigurt. Ibnul Kajim ka thënë: "Mënyra më e plotë është të agjërohet një ditë para Ashuras dhe një ditë pas".

- Agjërimi i ditës së Ashuras dhe i ditës së nëntë. Për këtë gjë kanë ardhur përcaktime të qarta siç u përmendën më lart.

- Agjërimi i kësaj dite të vetme.

Dita e ashuras është e rëndësishme për vlerat shpirtërore që simbolizon dhe atmosferën vëllazërore që sjell. Duke marrë si shkak këtë ngjarje, le të kujtojmë edhe një herë fqinj, le të bëhemi pengesë për unin tonë duke agjëruar, të pajtohemi me atë që nuk flasim dhe të kujtojmë devizën islame: "Të gjithë myslimanët janë vëllazër".

Është gjithashtu e rëndësishme që festave tona, ngjarjeve dhe eventeve jetike, t'u japim rëndësinë dhe vlerën e duhur. Kjo sepse feja është praktikë e jetuar, moral i dëshmuar dhe shembull konkret!

Islam Agolli

3. Muslimi

4. Transmeton Buhariu

5. Muslimi

RESPEKTI NDAJ EMRIT TË
Muhamedit a.s.



Ky është një tregim i cili dëshmon më së miri për respektin ndaj veprës, karakterit dhe emrit të Muhamedit a.s. të brezave të vjetër myslimanë.

Thuhet se një nga kalifët e nderuar në mesin e shoqëruesve të tij kishte një djalë të zgjuar dhe të ndershëm që quhej Muhamed. Djali i zbatonte me zell e korrektësi urdhrat e kalifit, dhe për këtë fitoi simpati të madhe.

Kur Kalifi e urdhëronte për diçka, e fillonte me emrin e tij të bukur, duke i thënë: "Muhamed, bëje këtë dhe këtë ...!" Të dy ishin të kënaqur: djali, sepse kishte një zotëri të tillë, ndërsa kalifi, sepse gjithmonë mund të mbështetej te djaloshi besnik.

Por, një ditë ndodhi diçka e papritur. Duke i dhënë urdhrat e zakonshme, në vend që t'i drejtohej në emër, kalifi i tha: O djalosh! Muhamedi mbeti i shtangur, dhe mendoi se ka diçka që nuk shkon. Kurrë më parë kalifi nuk i qe drejtuar në këtë mënyrë. Ditët kalonin, ndërsa djalin e mundonte shumë ai moment. Këtë e hetoi edhe babai, i cili një ditë e pyeti se pse ishte aq i dëshpëruar. Fillimisht djali ngurroi, por pastaj i tregoi babait arsyen e vërtetë.

- Baba, ti je mik i ngushtë i kalifit, të lutem pyete pse m'u drejtua në atë mënyrë? - i tha djali me lot në sy. Babai e ledhatoi dhe me një buzëqeshje të lehtë i premtoi se shumë shpejt do ta sqarojë këtë çështje.

Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Një ditë, i ati u gjat i vetëm me kalifin dhe e pyeti për shqetësimin e djalit. Kalifi e dëgjoji me kujdes, por në vend që t'i shpjegohej, ai i kërkoi që nesër të vinte së bashku me djalin. Kjo gjë e shqetësoi edhe më shumë djalin, i cili tërë natën nuk vuri gjumë në sy.

Në mëngjes herët, Muhamedi me babain shkuan te kalifi.

- Më thuaj Muhamed, çfarë të mundon? i tha Kalifi

- Babai jua ka thënë të gjitha, ia ktheu i emocionuar djali.

- Po, por unë dua ta dëgjoj prej teje. Deri më sot, më ke dëgjuar ti mua, kurse tani dua të dëgjoj unë ty.

Djali me zërin që i dridhej ia tregoi shqetësimin e tij, dhe priti përgjigjen e Kalifit. Kalifi u ngrit, shkoi ngadalë deri

te dritarja dhe hodhi sytë nga minaret e xhamive.

- Ai e di ti, Muhamed, se emri yt përmendet pesë herë në ditë në ato minare?, - e pyeti kalifi.

- E di, - tha djali me zë të ulët.

- A mund të më thuash se kush ishte Muhamedi?, - tha kalifi.

- Pejgamberi ynë dhe krenaria jonë, i biri i Allahut dhe Emine, atij që i është zbritur Kur'ani i Shenjtë, model për të gjithë ne që e pasojmë.

- I mençur dhe i ndershëm je ti, Muhamedi im, - vazhdoi Kalifi, - ashtu siç është i mençur dhe i ndershëm edhe babai yt, Abdulkerimi, që të vendosi një emër kaq të bukur. Nuk e kam menduar që vetëm pse të quajta djalosh do të shqetësonte aq shumë, por në anën tjetër, unë jam i kënaqur që ndodhi kështu. A ke menduar pse veprova kështu? pyeti Kalifi.

Në vend të përgjigjes djali uli kokën.

-Shiko, Muhamed, Allahu t'i ka dhënë të gjithë të mirat. Unë nuk do të mësoj e as nuk do të kritikoj, sepse nuk ke bërë asgjë të gabuar. Në vend të kësaj, do të zbuloj një sekret të cilin nuk ia kam treguar askujt. Të gjithë ato që i the për Muhamedin, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i ke thënë shumë bukur. Ai njëherë pati thënë se ne nuk do të jemi besimtarë të vërtetë derisa ai të mos jetë më i dashur për ne se vetja jonë. E tani, unë mundohem të jem sa më i mirë, duke ndjekur atë që ai e ka bërë, dhe t'i shmangem asaj që ai e ka ndaluar, e në fund Allahu do të na llogaritet veprat tona. Unë po të them diçka. Emri yt, që është edhe emri i Pejgamberit tonë të dashur, është më i zgjedhuri dhe më i bukur, prandaj unë kurrë nuk e kam përmendur pa pasur abdes. Atë ditë ndodhi që të jem pa abdes, prandaj të quajta djalosh, e jo Muhamed, siç kam vepruar zakonisht.

Djali mbeti i heshtur, por i gëzuar nga fjalët e kalifit.

Sinqueriteti DHE FRYTET E TIJ

I madhi Profit Hazreti Muhamed a.s. ka urdhënue:

“Asht detyrë e domosdoshme për ju me qenë të sinqertë, pse me të vërtetë sinqeriteti udh-heq në mirësi dhe mirësija me siguri udh-heqë në parajsë (xhenet).”

Çdo gjë në botë ka bukuritë veta qi e vleftësojnë dhe hijeshitë e saja qi e zbukurojnë, si sendet landore si edhe ato shpirtënore, e mbi çdo send asht njeriu.

Kjo krijesë e përsosun për bukuri e mrekulli, për me qenun në gradën e meritueshme të naltësisë, duhet të jetë e pajume me moralet e mira e të bukura; ky pajim asht vet qëllimi kryesor i fesë, i ligjit të saj moral e i fryteve dobidhanëse për familjen e sajë të madhe shoqnore. Kjo stoli e kësaj krijese, përmblihet e kryhet me mirësi, në gjinin e të së cilës grumbullohen gjith virtytet e nalta. Por si çdo gjë qi ka një bazë e një themel, ashtu edhe cilsitë morale kanë themelin e tyre; e ky themel asht sinqeriteti, sikur na e tregon edhe tradita profetike e parashtrueme sipri.

I madhi Profet a.s. në hadithin e sipërm ka folun tre sende: i pari difton themelin e gjanave ma kryesore, sinqeritetin; i dyti çfaq rezultatit e përcjellë nga sinqeriteti; dhe i treti difton frytin qi sjellë rezultati i sinqeritetit. Fillon pra me sinqeritet e thotë “asht detyrë e domosdoshme mbi ju me qenë të sinqertë, pse sinqeriteti me të vërtetë udh-heqë në të mirë, e mirësija siguron në mënyrë të padyshimtë parajsën. Nga rreshtimi i fjalive o nga përmbajtja e tyre na epet me kuptue se për ne njerëzit sendi ma i parë e ma i nevojshëm në gjith pikëpamjet asht

qi të jemi të pajuem me mirsi në gjith detyrat tona. Por, për me ekzistue mirësija në mënyrë të vazhdueshme duhet qi në shpirtin tonë të mbretnojë sinqeriteti plotësisht, pse ai asht baza e rraja e mirësis e fara e pemës së moraleve.

Sinqeriteti asht kondita e parë dhe sendi ma kryesor për veprimet e përgjithshme qi na detyron feja. Pse pa qenë i sinqertë në shpirtin e vet besimtar, s’ka vleftë as besimi i tij, natyrisht as edhe adhurimi qi ban e as puna qi punon.

Kur i mungon njeriut kjo cils kryesore, jo vetëm qi bahet asgja kundrejt të Madhit Zot, por edhe bahet fare i pa vleftshëm në mes të njerzis. Pra, sa ma i sinqertë të jetë njeriu, aq ma i gëzum, aq ma i plotë, aq ma i naltësuem e aq ma organ i vleftshëm asht për shoqni.

I madhi Profit a.s. asht pyetë një ditë se ç’asht naltsimi? Asht përgjegjun: “Fjala e drejtë e puna e sinqertë.”

Pra, asht plotësisht e vërtetë se sinqeriteti asht fara, burimi e shtylla e gjith cilësive morale e të çdo të mire qi rrjedhë prej tyre.

Çdo gjë ka shenjat e veta qi e tregojnë se çka asht. Çdo njeri, me punën qi merret kuptohet se, i cilës zeje ose karjere asht. Dhe për t’u ditun se në cilën kategori të moralit asht, i shiqohet sjellja e tij që e çfaqë ndër veprime të ndryshme qi ban me njerzin. Gjithashtu për t’ia ditun gradën e ndërgjegjes së tij, naltësin shpirtnore e idealin, i këqyret fjala qi flet e mendimi qi tregon, paralel me veprimet qi zbaton. Veç këtyne edhe, për t’ja



kuptue fuqin mendore, i vështrohet bisedimi dhe logjika e arsytimi qi rreshton. Pra, për t'ja kuptue njeriut të brendshmen përgjithsisht, i shiqohet dhe i vështrohet e jashtëmja krejtësisht, qi kështu e jashtëmja asht pasqyra e të brendshmes. Në këtë pikëpamje flasin këto dy tradita profetike me këto kuptime:

1. "Nuk ka marrë drejtim të plotë besimi i ndonjenit prej jush për pa ju drejtue zemra, dhe nuk ka marrë drejtim të plotë zemra e tij, për pa ju drejtue gjuha."

2. "Çdo gja ka peshën e vet e pësja e njeriut asht gjuha."

Pra, kur fjala e tij asht e kulluet, e mirë dhe e sinqertë tue u shoqnue me të edhe punët e veprimet qi ban vazhdimisht, njeriu i cilës do kategorije të gjykimit qoftë, randsin e sinqeritetit medoemos e pohon se ndër raste të ndryshme e bisedon, edhe në qoftë se ai vetë nuk vepron si lypset. Porse një njeri qi ka pasë fatin me u pajue me këtë cilsi të naltë e kryesore, gati përgjithsisht asht i sigurt nga mashttrimet djallëzore. Mendimet e dobta janë të zhdukuna krejt nga shpirti i tij. Ai gjithmonë asht i ashpër ndër fjalë, ndër punime e ndër veprime.

Ai nuk i shmanget kësaj cilësie të naltë as ndër raste kënaqësjie as ndër raste deshprimi; as në gjansi as në ngushticë; as në siguri as në rrezik; si doqoftë e kudoqoftë, të drejtën e flet lirisht dhe e zbaton pa ju trembë syni e pa ju frigue zemra. Sikur vetë qi asht i sinqertë ashtu edhe sinqeritetin e don, e pranon dhe gëzohet kur e ndijon.

Sinqeriteti qi tregon një i tillë person, ban efektin e mirë

edhe ndër zemrat e njerëzve të tjerë, ndaj të cilëve edhe në qoftë fajtor, i lehtësohet deri diku faji, ndoshta edhe i falet. Sepse kjo cilsi, asht ma e dashtuna dhe me të na urdhnon i Madhi Zot dhe me të na urdhnon qi të pajohemi e të veprojmë në të gjithë punët e jetës sonë. Pra me qenë se asht ma e dashtuna cilsi, ajo dashtuni, sjellë zemrat e njerëzve në mirësi kundrejt të sinqertit, qi kështu rezulton shpëtimin e tij. Shpëtimi qi gëzon i sinqerti ndër raste lirije e drejtsije, asht i pa dyshimtë, por edhe ndër raste rreziku prapë se prap asht i fituem, o në të dy jetët ose n'atë të amshueshmen vetëm. E për këtë arsye kësaj cilsije të naltë s'duhet qi t'i shmanget njeriu kurrë në qoftë edhe në ma të madhin rrezik. Qe këto të vërteta sa bukur na i mëson ai Edukues moral, Hz. Muhamedi a.s. me këtë hadith.

"Përveshjuni sinqeritetit edhe në qoftë se në të shifni humbjen (helaqin), pse me të asht shpëtimi; dhe largonju rrenës edhe në qoftë se në të shifni shpëtimin, pse në të është humbja".

Pra kjo cilsi me qenë se asht rranja e çdo të mire asht e domosdoshme për atë qi don me qenë njeri e i lumtur, me u pajue me të e mos me u çvesh as një herë prej sajë, mbasi kjo udhëheq në mirsi e mirsija natyrisht udhëheq në lumninë e dy jetve.

H. T.
Kultura Islame, Maj-Qershor 1943



HAFIZ IBRAHIM REPISHTI

(1882-1943)

Hafiz Ibrahim Repishti është një personalitet i shquar i jetës qytetare, politike, shoqërore e fetare në qytetin e tij të lindjes, Shkodër.

Nga një vështrim përgjithësues i jetës dhe i veprimtarisë së Hafiz Ibrahim Repishtit dallohen qartë dy periudha:

Njëra është e ngjeshur me përpjekje të shumta atdhetare, luftarake, politike e shoqërore, gjatë së cilës ai luan një rol tepër aktiv në luftë për mbrojtjen e atdheut kundër sulmeve sllave, në luftë për interesat kombëtare, në përpjekje për themelimin e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të tij demokratike. Në këtë etapë të jetës ai i shkrin në një kontekst interesat kombëtare me pikëpamjet islame.

Periudha e dytë e veprimtarisë së tij lidhet me idealet dhe moralin e lartë islam. E gjithë përgatitja e tij, dituria dhe përvoja e tij, tashmë drejtohet në këtë objektiv, në përhapjen e besimit islam.

Hafiz Ibrahim Repishti ka lindur në vitin 1882 në lagjen Dudas, në Shkodër. Dudas ishte një lagje me tradita të vjetra islame e njohur edhe për devotshmëri fetare dhe atdhetarizëm. I ati i Hafiz Ibrahim, H. Jusuf Repishti, do të nënshkruante memorandumun e 13 qershorit 1878, dërguar Kongresit të Berlinit, për mbrojtjen e tokave shqiptare. Haxhi Jusufi ishte zgjedhur gjithashtu kryetar i komisionit për financimin e forcave të Lidhjeve të Prizrenit për Shkodrën, komision i cili mblidhte ndihma për ushtrinë vullnetare që të mbronte tokat shqiptare nga ushtritë e Malit të Zi.

Hafiz Ibrahim, duke ndjekur traditën e familjes merr një edukatë të shëndoshë fetare, ndjek mejtepin e njohur të lagjes dhe pastaj vazhdon studimet në Medresenë e Pazarit.

Në vitin 1907 shkon në Stamboll për të ndjekur studimet e larta teologjike dhe diplomohet në shkencën e Sheriatit. Kthehet në vendlindje në vitin 1912.

Në rrethimin e Shkodrës nga forcat malazeze në vitin 1913 u bë një mbrojtje e rrallë nga qytetarët shkodranë me në krye komandant Hasan Riza Pashën. Në radhët e luftëtarëve vullnetarë krahas shumë klerikëve të tjerë myslimanë, u rreshtua edhe Hafiz Ibrahim Repishti. Ai gjithashtu mbulonte pjesën më të madhe të shpenzimeve për ushqimin e vullnetarëve të lagjes Dudas. Për shtatë muaj rresht ai nuk u largua asnjë ditë nga vija mbrojtëse e vullnetarëve.

Me mbarimin e luftës Hafiz Ibrahim Repishti angazhohet në veprimtarinë arsimore. Kështu krijohet këshilli i ri arsimor pranë Bashkisë. Kryetari i parë i këtij këshilli ka qenë kadiu i Shkodrës, Xhemal Naipi. Pastaj Hafiz Hysejn Vuthi e në shtator 1919, Hafiz Ibrahim Repishti. Anëtarët e këtij këshilli ishin personalitete të shquara si: Hafiz Abaz Golemi, drejtor i shkollës së Parrucës, At Gjergj Fishta, drejtor i shkollës së Fretërve, Gaspër Mikeli, drejtor i shkollës popullore, Hafiz Hysejn Vuthi, drejtor i shkollës Rus Haslikaj, Sheuqet Muka, etj.

Si kryetar i këtij këshilli arsimor, ai do të luajë një rol me

rëndësi për arsimimin e bijve të qytetit të Shkodrës. Një rëndësi të veçantë i kushton edhe mësimin të besimit në shkollat e shtetit. Në arkivin e Muzeut të Shkodrës ka një dokumentacion të pasur lidhur me këtë problem.

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore dhe krijimin e Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, ai përkrah këtë lëvizje duke bërë të mundur zhvillimin e disa mbledhjeve të këtij komiteti në shtëpinë e tij.

Hafiz Ibrahim Repishti vazhdoi pandërprerë të punonte për atdheun dhe për fenë si dhe pasuroi bibliotekën e trashëguar nga i ati duke e bërë një nga më të mirat në qytet.

Në luftën politike në vitet 1920-24, Hafiz Ibrahim Repishti zë një vend të veçantë. Në votimet e dhjetorit 1923 Hafiz Ibrahim zgjidhet përfaqësues i qytetit të Shkodrës, anëtar i Asamblesë Kushtetuese e më vonë deputet.

Gjatë qëndrimit të tij në Parlament ka kryer funksionet e nënkryetarit të komisionit parlamentar për jurisprudencë dhe të komisionit parlamentar për arsimin. Delegacioni parlamentar i Shkodrës përfshinte klerikë katolikë dhe myslimanë si: At Gjergj Fishta dhe Hafiz Ibrahim Repishti.

Hafiz Ibrahim në shënimet e tij biografike do të vinte theksin te kjo harmoni ndërfaqë, e cila ishte e rrallë dhe unikalë për të gjithë Ballkanin e atyre viteve.

Ai ka qenë pjesë e qeverisë së Nolit dhe pas shpalljes së Monarkisë në Shqipëri tërhiqet nga jeta politike. Kështu, nga viti 1925 deri në vitin 1943 ka shërbyer si imam i xhamisë së Dudasit, duke iu përkushtuar tërësisht jetës fetare dhe edukimit të banorëve me besimin në Zotin dhe me moralin e lartë islam. Ai dinte disa gjuhë të huaja dhe shfrytëzonte rregullisht bibliotekën e tij të pasur.

Pas vitit 1925 ai ka qenë gjithashtu mësues për shumë të rinj që i ishin përkushtuar studimeve islame. Sipas familjarëve, Hafiz Ibrahim ka shkruar mjaft artikuj në revista të ndryshme të Egjiptit dhe Marokut.

Hafiz Ibrahim Repishti, si një qytetar i mbujtur me idealet më të larta atdhetare e demokratike, si një imam i shquar i pajisur me cilësi të larta morale e fetare, bëri që me pushtimin fashist të 1939, të gjendej kundërshtar i këtij pushtimi. Lidhur me këtë, i biri, prof. Sami Repishti, në librin e tij "Pika loti", shpjegon bastisjen dhe torturat e fashistëve në shtëpinë e tyre gjatë një nate të errët, tortura të cilat sollën hemorragji cerebrale dhe shkaktuan ndërrimin jetë pas dy javësh, 29 shtator 1943, të Hafiz Ibrahim Repishtit.

Familja e tij u ndoq dhe u persekutua edhe nga regjimi komunist, të cilat prof. Sami Repishti i ka shpjeguar në tregimet dhe librat e tij.

Hafiz Ibrahim Repishti si demokrat, si atdhetar dhe si fetar, la një emër të nderuar në të gjithë plejadën e ndritur të hoxhallarëve të shquar të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë.¹

1. Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, "Në kujtim të brezave", Rozafat, 1997: 263-280

Edukimi fetar merret që në barkun e nënës!

Jo vetëm zhvillimi fizik dhe mendor, por edhe ai moral dhe fetar është i lidhur me mënyrën e jetesës së nënës gjatë shtatzënisë. Hapat e parë duhet t'i hedhim në këtë fazë, nëse dëshirojmë që fëmija ynë të ketë një zhvillim moral dhe fetar të mirë.

Për të rritur fëmijë të mirë dhe të moralshëm, sipas fesë sonë, nëna që nga shtatzënia duhet të bëjë kujdes me mënyrën e jetesës së saj. Që nga e ngrëna dhe e pira deri te sjelljet ndikojnë në zhvillimin shpirtëror dhe të karakterit të fëmijës në barkun e nënës.

Edukimi i fëmijëve, të cilët Kur'ani Fisnik i përkufizon si "stoli e jetës së kësaj bote", është një çështje e cila zë vend të rëndësishëm në jetën e çdo prindi, sepse është e vështirë të rritet një fëmijë i moralshëm, i dobishëm për shoqërinë. Prandaj, ata të cilët kanë vendosur të bëhen prindër, veprojnë me vetëdijen se po hedhin hapa drejt një procesi të vështirë. Disa lexojnë libra rreth zhvillimit të fëmijëve, disa të tjerë këshillohen me specialistë të fushës. Por, vetëm këto nuk janë të mjaftueshme për të rritur një fëmijë fetar, të edukuar dhe zotëruar të vlerave morale. Profeti a.s.,

i cili është këshilluesi ynë në çdo çështje, në këtë rast edhe në edukimin e fëmijës, thotë: "Ai që është për xhehenem (shaki) është që në barkun e nënës, ai që është për xhenet (sa'id) është që në barkun e nënës", duke na tërhequr vëmendjen se edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës. Pra, feja jonë, e cila i kushton rëndësi të veçantë edukimit të fëmijës, na tregon se të pasurit fëmijë të mirë është në dorë të nënës dhe babait. Teologët thonë se për këtë duhet vepruar sipas "edukatës së shtatzënisë". Edukatën e shtatzënisë e sqarojnë me hadithin e Profetit a.s. i cili thotë: "Gjeni një vend të mirë për farën tuaj (nutfeh), sepse rrënjët trashëgohen". I Dërguari i Allahut a.s. në këtë hadith tregon se morali dhe edukata e prindërve trashëgohet te fëmija. Prandaj, për të pasur fëmijë të mirë, duhet të fillohet që nga zgjedhja e bashkëshortit/bashkëshortes, e deri te jetesa sipas rregullave të fesë pas shtatzënisë. Diçka tjetër është afrimi i bashkëshortëve sipas traditës profetike (sunetit), ashtu siç Profeti a.s. ka thënë: "Në emër të Allahut! O Allah, largo shejtanin prej nesh dhe prej atij të cilin ke dhënë të niset (fëmijës)! Nëse Allahu jep që me atë rast të niset ndonjë fëmijë, shejtani nuk

do t'i bëjë dëm!" (Transmeton Buhariu dhe Muslimi). Ky është një ndër treguesit se si mënyra e jetesës së prindërve ndikon fëmijën.

Po të shikohet me kujdes, qëndrimin e fesë sonë rreth kësaj teme e mbështesin edhe shumë kërkime shkencore. Kërkimet shkencore në mbarë botën tregojnë se fëmija fillon ta perceptojë botën që nga barku i nënës dhe që në barkun e nënës fëmija formon tridhjetë për qind të personalitetit të tij. Rreth kësaj kemi shumë shembuj nga jeta e prindërve të shumë dijetarëve, nënat e të cilëve gjatë shtatzënisë nuk hidhnin një hap pa abdes, ndërsa pas lindjes nuk i ushqenin asnjëherë duke qenë pa abdes, përveç ditëve të veçanta. Ndërsa baballarët bënin kujdes të mos sillnin furnizim haram në shtëpi, duke bërë kujdes në fitimin e tyre.

Babai i Imam Ebu Hanifes dhe molla

Një ditë, babai i themeluesit të shkollës juridike hanefite Imamu'l-A'dham Ebu Hanifes, Nu'man bin Thabit, kur po merrte abdes pranë një përroi. Sapo do të fillonte të merrte abdes shikon një mollë të cilën e kishte marrë uji. Pa e menduar se nga vjen, a është hallall apo haram, e kafshon mollën. Deri në atë moment, Nu'mani, i cili nuk e kishte menduar nga kishte ardhur molla, e kupton gabimin dhe mendon se duhet të gjejë të zotin dhe t'i kërkojë hallallin. Ai u nis andej nga vinte uji. Me mollën në dorë, duke kërkuar, gjen bahçen nga ku kishte rënë molla dhe të zotin e saj.

Ja shpjegon situatën dhe i kërkon hallallin. Ky veprim i Nu'manit i tërhoqi vëmendjen të pronarit të bahçes dhe i thotë që për t'ia bërë hallall kishte disa kushte. Nu'mani i thotë që pranon çdo gjë, vetëm t'ia bëjë hallall. Tjetri i thotë që duhet t'i shërbejë atij dy vite duke punuar në bahçen e tij. Nu'mani mendon: Më mirë t'i shërbej dy vite, sesa të vuaj dënimin në botën tjetër dhe pranon. Pasi dy vitesh shkon pranë të zotit të bahçes, i thotë që koha është mbushur dhe i kërkon hallallin. Burri i thotë: "Sërish nuk ta bëj hallall. Kam një vajzë dhe vetëm po u martove me të do ta bëj hallall". Nu'mani pranon. Por burri i thotë se vajza e tij kishte të meta fizike. Ishte e verbër, e çalë dhe shurdhe. I thotë ta mendojë mirë që të mos pendohet pastaj. Duke menduar sërish si më parë, që më mirë dënimin në këtë botë se në tjetrën, pranoi. Pasi bëhet dasma dhe shikon nusen, mendon se ka ndodhur ndonjë gabim dhe nuk është ajo nusja e tij, sepse vajza që shikon nuk kishte asnjëherë prej cilësive që burri i pati thënë. Shkon të pyesë të vjehrrin dhe ai i thotë: "Ime bijë është e verbër, sepse nuk ka parë haram. Është shurdhe, sepse nuk ka dëgjuar haram. Është e çalë, sepse nuk ka ecur në rrugë të ndaluar". Pasi kaluan vite nga kjo martesë lindi Imam Ebu Hanife. Nëna e tij e dërgon te mësuesi i tij për ta edukuar. Ebu Hanife, i cili më vonë do të merrte titullin "Imamu'l-A'dham", që në moshën tre vjeçare e mbaroi Kur'anin

për tri ditë. Për këtë, nëna e tij i tha: "Ah, mor bir! Sikur babai yt mos ta kishte kafshuar atë mollë do ta mbaroje për një ditë".

Sa me ndjeshmëri kanë jetuar njerëzit më parë, saqë për diçka tepër të vogël, që mund të duket e parëndësishme tregonin kujdes dhe largoheshin nga të ndaluarat. Pikërisht prej atyre njerëzve kanë dalë dijetarë të mëdhenj si Imam Ebu Hanife e të tjerë.

Dy shtatzëni të ndryshme, dy karaktere të ndryshme

Historia e babait të Imam Ebu Hanifes është vetëm një ndër shembujt e shumtë të asaj kohe. Shembujt e mësipërm mund t'i gjejmë edhe në ditët tona. Një myslimane tregon se në shtatzëninë e saj të parë nuk kishte bërë kujdes me namazet dhe me të ngrënë dhe të pirët, ndërkohë që në të dytën kishte bërë kujdes në çdo drejtim. Nuk i linte namazet, kujdesej të lexonte çdo ditë Kur'an, largohej nga thashethemet, sillej mirë me të tjerët, etj. Ndryshimin e kuptoi pasi lindi dhe fëmija filloi të rritej. Fëmija i parë ishte më i shkujdesur, jo shumë i prirur për sa i përket pjesës fetare, ndërsa i dyti ishte i sjellshëm dhe i rregullt me namazin dhe Kur'anin, aq sa fjala e tij e parë ishte "Allah"!

Historinë e mësipërme e mbështet edhe një eksperiment i bërë në Amerikë. Pranë një gruaje shtatzënë lexohet një tregim. Pas disa kohësh pas lindjes e njëjta histori i lexohet fëmijës. Fëmija e njeh dhe buzëqesh. Ndërkohë që kur i lexohet një histori tjetër nuk reagon. Shkencëtarët këtë e sqarojnë me perceptimin e botës së jashtme nga fëmija që në barkun e nënës. Prandaj, duhet theksuar edhe njëherë se kandidatet për nëna duhet të bëjnë kujdes me të ngrënë, të pirët dhe mënyrën e jetesës së tyre.

Kriteret se si duhet të kalohet shtatzënia janë shumë të qarta në fenë tonë. Teologët thonë se ata të cilët jetojnë brenda kornizës së caktuar nga feja nuk do të kenë probleme, sepse mirësjellja dhe edukata në Islam është të jetosh sipas urdhrave të Zotit. Dhe kjo kornizë është e përbërë nga kryerja e lutjeve, fitimi i furnizimit të lejuar (hallall), forcimi i anës shpirtërore, qëndrimi larg të ndaluarës dhe kryerja e adhurimeve të detyrueshme. Furnizimi i lejuar (hallall) ndikon në moralin e personit. Prandaj, që të kemi fëmijë të moralshëm duhet të dimë nëse ajo që çojmë në stomak është e lejuar apo e ndaluar. Ndjeshmëria e nënës ndaj namazit dhe Kur'anit gjatë kësaj periudhe, e mëson fëmijën me namaz dhe Kur'an që në barkun e saj. Gjithashtu kujdesi i saj ndaj mbulesës së saj, përveç çfarë Allahu ka lejuar të zbulohet, mundëson që fëmija në të ardhmen ta mbrojë veten nga e ndaluara (harami). Mbi të gjitha, në sajë të gjithë këtyre që përmendëm, fëmija kur është fetus është i qetë dhe lind i shëndetshëm.

Ana Haxhiu

PËRKUJDESJA DENTARE DHE HIGJIENA ORALE

Si të kemi dhëmbë të bukur dhe të shëndetshëm?

Për t'u kujdesur në mënyrën më të mirë për dhëmbët dhe për t'i kushtuar shëndetit të tyre rëndësinë e duhur, më parë duhet të jemi të mirinformuar për funksionet e rëndësishme që ata kanë. Funksioni kryesor i dhëmbëve është prerja, copëtimi dhe bluarja e ushqimit. Por krahas kësaj, vlen të përmendet që dhëmbët luajnë rol edhe në shqiptimin e duhur të fjalëve, sidomos të bashkëtingëlloreve: s, t, th etj. Gjithashtu vlen të theksohet se dhëmbët kanë një rëndësi të madhe estetike, një arsye tjetër kjo që mjafton për të na bindur mbi kujdesin që duhet të tregojmë ndaj tyre.

Padyshim që të gjithë dëshirojmë të kemi dhëmbë të bukur e të shëndetshëm, por çfarë duhet të bëjmë që kjo të mos mbetet thjesht një dëshirë? Më poshtë do të paraqesim disa këshilla të thjeshta për t'u realizuar dhe të vlefshme për gjithsecilin prej nesh:

- Çdo gjashtë muaj shkoni te dentisti juaj
- Përdorni, në qoftë se është e mundur, furçë dhëmbësh pas çdo vakti, ose ndryshe bëni larje të rregullt në mëngjes e në mbrëmje.
- Shmangni përdorimin e furçave me fije të ashpra, pasi jo vetëm mund t'ju dëmtojnë mishrat e dhëmbëve, por, si rezultat i kësaj, do të keni ndjeshmëri të paimagjinueshme kur të bini në kontakt me ushqimet e ngrohta apo edhe të ftohta.
- Ndryshoni furçën çdo gjashtë muaj.
- Lajini dhëmbët në çdo sipërfaqe të tyre, dhe në pikën e kontaktit me mishrat, por edhe gjuhën, pasi

në këtë mënyrë largoni bakteret e grumbulluara aty dhe shmangni aromën e keqe të gojës.

- Kujdesi në ushqyerje: Ndaloni duhanpirjen, reduktoni konsumin e ëmbëlsirave. Shtoni në menunë tuaj vitaminat esenciale A + D, proteinat, hekurin, acidin folik dhe zinkun. Dentisti është ai që ju përcakton përdorimin e drejtë të të lartpërmendurave.

- Zgjidhni pastë të përshtatshme dhëmbësh në varësi të përdorimit të saj. Për shembull, ka disa pasta specifike për ndjeshmëri ndaj pijeve të ngrohta, apo të ftohta, po ashtu ka edhe të tjera që ndihmojnë në parandalimin e prishjes së dhëmbëve.

- Shmangni përdorimin e dhëmbëve si mjete prerëse.

Pa dyshim që të gjithë jemi të interesuar të dimë si të kujdesemi për të pasur dhëmbë të shëndetshëm dhe të bukur edhe kur jemi jashtë klinikave dentare. Lind pyetja se a ekziston një përbërës natyral që të zëvendësojë pastën dhe furçën e dhëmbëve ?

Është e domosdoshme që dhëmbët të lahen dy herë në ditë, por të ndodhur nën efektin e rutinës së përditshme mund të mos arrijmë ta zbatojmë këtë parim primar, sepse në mëngjes mund të jemi vonë për të shkuar në punë apo në shkollë, ndërsa në darkë mund të ndihemi të lodhur nga aktiviteti i ditës që lamë pas. Kjo mënyrë të vepruari do të çonte në dëmtim të parikuperueshëm të dhëmbëve dhe përkeqësim të shëndetit të tyre, gjë që do të shfaqte efektin e tij në të gjithë organizmin. Për të shmangur këtë pasojë të rrezikshme ne ofrojmë një këshillë të thjeshtë për



t'u zbatuar me anë të së cilës ju do të keni efektet e dëshiruara. Përdorni misvak, është e thjeshtë dhe e shëndetshme në të njëjtën kohë. Nuk ka efekte anësore apo përbërës të rrezikshëm kimikë. Zë pak hapësirë dhe mund ta vendosni në xhepin e çantës apo të pantallonave. Përdorimi i tij nuk ju merr shumë kohë.

Pasi mësuam se përdorimi i tij ka vlerë në aspektin praktik, le të shohim sa vlen ai në atë mjekësor dhe fetar. Nga historia islame dimë që Profeti a.s. e përdorte misvakun dhe ia këshillonte këtë edhe shokëve të tij. Transmetohet nga Aishja r.a. se ai ka thënë: "Namazi para të cilit është përdorur misvaku është 70 herë më i vlefshëm sesa ai në të cilin nuk është përdorur ai".

Për sa i përket aspekteve dobiprurëse të misvakut në terminologjinë mjekësore mund të flasim me fakte shkencore, sepse ka një sërë studimesh shkencore që i vërtetojnë ato. Më poshtë do të paraqesim saktësisht 4 studime shkencore të kryera mbi misvakun dhe çfarë u mësuam prej tyre:

1. Kompania e famshme Wrigley (e njohur për prodhimin e çamçakëzëve dhe produkteve të mentes) bëri një studim mbi misvakun. Studimi nxori në pah që bashkimi i mentes me ekstraktin e misvakut ishte 20 herë më efektiv në vrasjen e baktereve se sa menteja e zakonshme. Një tjetër fakt që e dëshmon këtë është se pas gjysmë ore bashkimi i mentes me ekstraktin e misvakut kishte vrarë 60% të baktereve, ndërsa me përdorimin e mentes së zakonshme vetëm 3.6% e tyre.

2. Në gusht revista e periodontologjisë (2008) realizoi

një studim drejtuar nga kërkuesit suedez mbi misvakun. Studimi nxori në pah që copëzat e misvakut ishin në gjendje të vrisnin bakteret dhe të kuronin sëmundjet periodontale. Për këtë arsye shkencëtarët e sugjeruan përdorimin e tij.

3. Një studim i kryer nga Pubmed që krahasoi misvakun me furçën e dhëmbëve konstatoi që misvaku ishte më efektiv se furça e dhëmbëve në reduktimin e pllakave dentare dhe infeksioneve të dhëmbëve.

4. Në një studim tjetër është provuar fakti se në përbërjen e misvakut përveç përbërësve shumë të dobishëm gjendet edhe një element që nuk gjendet në natyrë në një formë tjetër. Ai është platiniumi.

Po cilat janë dobitë e drejtpërdrejta që vijnë si pasojë e përdorimit të misvakut? Më poshtë do të rendisim disa prej tyre që mendojmë se janë më të rëndësishmet:

- Përmirëson memorien.
- Eliminon papastërtitë që gjenden në dhëmbë.
- Ndhmon në qetësimin e dhimbjes së dhëmbëve.
- Eliminon njollat e verdha në dhëmbë.
- Ndhmon në shëndetin e të gjithë trupit.
- Trajton një sëmundje të gojës që quhet Qilaa.
- Qartëson zërin.
- Përmirëson të folurën.
- Rrit inteligjencën.

Sherife Kalaja

Kujdesi për jetimin



Profeti ynë i dashur, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ndjente një dhembshuri të madhe ndaj fëmijëve jetimë. Ndaj tyre ishte shumë, shumë dashamirës. Ngaqë dhe vetë ai u vetëm dhe e kuptonte fare mirë se ç'do të thotë të jesh jetim. E dinte shumë mirë se sa e dhimbshme dhe e vështirë ishte kjo ndjenjë. Nga mëshira e madhe që kishte për jetimët, vazhdimisht i mbronte ata dhe kur atyre u bëhej ndonjë padrejtësi, gjithmonë kërkonte të drejtat e tyre.

Fëmijët e shokëve të tij, të cilët binin dëshmorë nëpër luftëra mbeteshin jetimë Profeti a.s. interesohej shumë, kujdesej për ta, kurrë nuk i linte vetëm dhe ua plotësonte nevojat e tyre. Disa prej tyre i merrte nën kujdestarinë e tij.

Teksa po dilte nga xhamia pas namazit të Bajramit, Profeti a.s., pa fëmijët që po luanin me gaz e hare. Ndërkohë i tërhoqi vëmendjen një fëmijë i mbështetur pas murit, me rroba të grisura e në gjendje të mjerueshme, duke qarë. Iu afrua atij dhe i tha:

- Vogëlush! Çfarë ke? Pse rri i mërzhitur? Përse nuk luan me shokët e tu?

Fëmija ishte jetim. Babai i tij kishte rënë dëshmor në luftën e Uhudit, nëna e tij ishte martuar me një tjetër dhe ai kishte mbetur i vetëm. Profeti ynë i dashur i kapi dorën dhe i ledhatoi kokën duke i thënë:

-Pse qan? A nuk do që babai yt të jem unë, nëna jote Aishja dhe motra jote të jetë Fatimja?

Fëmija nga gëzimi i madh sa s'po fluturonte. I emocionuar ia ktheu:

- E si të mos jem i kënaqur, o Profet i Zotit?

Profeti e mori fëmijën dhe e çoi në shtëpinë e tij. E ushqeu dhe e veshi. Tanimë që ishte i ngopur dhe i mbrojtur, doli përsëri që të luante me fëmijët e tjerë. Pse të mos gëzohej? Babai i tij kishte ikur në Parajsë (Xhenet), por tani në vend të tij ishte babai më i mirë në botë.

Kur fëmijët e tjerë vunë re tek ai ndryshimin, u mblodhën rreth tij dhe me kuriozitet e pyetën:

-Ti më parë vetëm qaje, kurse tani je ndryshe. Vallë ç'të ka ndodhur?

- Isha i etur, u ngopa, isha i zhveshur, u vasha, isha jetim, tani Profeti i Zotit është babai im dhe Aishja është nëna ime, - tha ai i lumtur.

Pas kësaj, fëmijët duke lakmuar fatin e shokut të tyre jetim thanë:

-Ah, sikur dhe baballarët tanë të ishin dëshmorë dhe ne të kishim fatin e të pasurit një baba të tillë!

Fëmija ndenji pranë Pejgamberit a.s. derisa ai ndërroi jetë.

Sikur vetëm kokën ti ledhatosh një jetimi fiton një sevap shumë të madh dhe pikërisht ky gjest është sihariq për Xhenetin.

Profeti ynë a.s. shprehet kështu për këtë sevap të madh:

"Kush ledhaton kokën e një jetimi, vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit, për të ka aq sevape sa flokët që prek dora e tij. Ai njeri që i bën mirësi jetimit pranë tij, në Xhenet do të jetë afër meje si këto dy gishta" dhe më pas tregoi afërsinë e dy gishtave.

Kush e blen këtë skllav?

Profeti a.s. kishte një skllav me emrin Zahire. Zahire jetonte në shkretëtirë. Herë pas here, ai i sillte të Dërguarit të Allahut dhurata nga lulet dhe frutat e shkretëtirës. Pejgamberi gjithashtu e gëzonte me dhurata, të cilat ishin të nevojshme në shkretëtirë. Zahire ishte njëri ndër sahabet me të cilin Profeti bënte shumë shaka. Dhe thoshte për të:

- Zahire është shkretëtira jonë, ndërsa ne jemi qyteti i tij.

Zahire i cili merrej me tregti, sërish një ditë kishte ardhur në qytet për të shitur ca gjëra. I Dërguari i Allahut, pa e parë ai, i shkoi nga mbrapa dhe pasi e kapi nga krahët, i mbylli sytë. Zahire i shqetësuar, duke thënë:

- Kush je ti? Më lësho! u kthye mbrapa.

Kur pa që ishte i Dërguari i Allahut u qetësua dhe e vendosi kokën në kraharorin e Tij të mëshirshëm.

I Dërguari i Allahut e vazhdoi shakanë duke pyetur:

- Kush e blen këtë skllav?

Dhe Zahire iu përgjigj:

-Nuk do të gjeni ndonjë blerës, o i Dërguar i Allahut. E çfarë vlere kam unë?!

I Dërguari i Allahut tha:

-Ndoshta në pamje ashtu je, por tek Allahu je një rob (skllav) i shtrenjtë e me vlerë të madhe.



PËRZGJIDH KOLEGJIN UNIVERSITAR BEDËR NË PORTALIN U-ALBANIA



FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË

- Drejtësi
- Gazetari dhe Komunikim Multimedial
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu
- Shkenca Islame
- Multimedia dhe Dizajn Grafik

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË DHE BIZNESIT

- Finance Kontabilitet
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Kompjuterike
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Programim në Web

www.beder.edu.al

